# EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 5999
E mërkurë, 12 shkurt 2020
çmimi 0.40 €


## Kryediplomati italian kërkon nga Kosova t'i rikthehet dialogut FAQE 7




Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de


KRYEMINISTRI I KOSOVËS, ALBIN KURTI, KA REALIZUAR VIZITËN E PARË ZYRTARE NË SHQIPËRI FAQE 4-5

# KRYEMINISTRAT PAJTOHEN PËR NJË FILLIM TË FUQISHËM TË BASHKËPUNIMIT KOSOVË - SHQIPËRI

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, janë marrë vesh për një fillim të fuqishëm të bashkëpunimit Kosovë - Shqipëri. Gjatë vizitës së tij të parë zyrtare në Shqipëri, kryeministri Kurti ka thënë se Kosova dhe Shqipëria janë prioritet i njëra-tjetrës dhe nuk janë çështje që presin në asnjë fushë. Krerët e dy qeverive janë pajtuar ta formojnë një komision ndërshtetëror, i përbërë nga ministra dhe deputetë, që të sigurohen se 77 marrëveshjet e nënshkruara nga qeveritë e dy vendeve duhet të zbatohen dhe të arrihen marrëveshje të reja. Megjithatë, ata kanë shprehur mendime të ndryshme për minishengenin ballkanik





## Emisari i presidentit Trump ripërsërit kërkesën për heqjen e taksës FAQE 3



## "Bleibende Spuren" prezantohet për herë të shtatë në Zvicër FAQE 11

## AKTUALE



PDK-ja SHPALL ZGJEDHJET PËR FORUMIN E GRUAS F. 7

REKA NË TAKIM ME APOSTOLOVËN THEKSON RËNDËSINË E FINALIZIMIT TË PROCESIT F. 7

AAK-ja: DO T'I PËRDORIM TË GJITHA MJETET DEMOKRATIKE PËR MBAJTJEN E TAKSËS 100 PËR QIND F. 3

KQZ KUFIZON SHPENZIMET E SUBJEKTEVE POLITIKE PËR FUSHATËN ZGJEDHORE NË PODUJEVË F. 6

## EKONOMI

KOSOVA DHE EMIRATET E BASHKUARA ARABE SHKËMBEJNË PËRVOJAT NË FUSHËN E AUDITIMIT F. 9

ATK-ja IDENTIFIKON 200 BIZNESE QË BËJNË SHMANGIE TË TATIMIT F. 8

MBI 1 MILION E 500 MIJË EURO DËME NGA ERËRAT NË ISTOG F. 9

## KULTURË

OH, NEXHË! F. 12



Elife PODVORICA


RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht –Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

# Maqedonia e Veriut ratifikoi protokollin e anëtarësimit në NATO



Vendimi për ratifikimin para kohe të protokollit për anëtarësimin e Maqedonisë Veriore në Aleancën Veriatlantike është marrë për shkak se kuvendi do të shpërndahet më së voni deri më 16 shkurt, meqë më 12 prill të këtij viti do të mbahen zgjedhjet e parakohshme parlamentare

**Shkup, 11 shkurt** - Kuvendi i Maqedonisë së Veriut ka ratifikuar protokollin për anëtarësimin e vendit në Aleancën Veriatlantike, por në fuqi do të hyjë pas ratifikimit të këtij dokumenti edhe nga shteti i fundit anëtar i NATO-s, Spanja, e cila, për shkak të zhvillimeve politike, ende nuk e ka bërë një gjë të tillë. Për ratifikimin e protokollit kanë votuar të gjitha partitë politike në pushtet dhe opozitë.

Autoritetet maqedonase presin që Spanja ta ratifikojë protokollin në muajin mars. Vendimi për ratifikimin para kohe të protokollit nga Maqedonia e Veriut është marrë për shkak se kuvendi do të shpërndahet më së voni deri më 16 shkurt, meqë më 12 prill të këtij viti do të mbahen zgjedhjet e parakohshme parlamentare. Pas miratimit të protokollit, flamuri i NATO-s është ngritur para ndërtesës së kuvendit në Shkup.

Zhbllokimi i procesit të integrimit euroatlantik erdhi pas ardhjes në pushtet të LSDM-së që drejtohet nga ish-kryeministri Zoran Zaev, i cili zgjidhi kontestin për emrin me Greqinë.

Presidenti i Maqedonisë së Veriut, Stevo Pendarovski, tha se anëtarësimi në NATO nuk do të ishte i mundur pa ndryshimet e mëdha që kanë ndodhur viteve të fundit, si raportet e mira me fqinjët dhe marrëveshja me Greqinë, pa të cilat, sipas tij, nuk mund të paramendohej arritja e këtij momenti, ratifikimi i protokollit për anëtarësim në NATO. "Anëtarësimi në NATO, privilegj dhe obligim është rrumbullakim i shtetësisë dhe sovranitetit të shtetit", ka deklaruar Pendarovski.

Në një paraqitje para opinionit, Zaev ratifikimin e protokollit e vlerësoi si arritjen më të madhe të vendit pas pavarësisë nga ish-shteti komunist i Jugosllavisë. "I gjithë populli ynë, të gjithë qytetarët tanë, janë krenarë për këtë sukses tonin. Maqedonia e Veriut anëtarja e 30-të e NATO-s. Të gjithë ne, maqedonas, shqiptarë, turq, serbë, romë, vllahë, boshnjakë jemi pjesë e Aleancës më të fuqishme në botë. Pas shumë dekadave pasiguri, bllokada, regjim, izolim, përfundimisht i hapëm rrugën anëtarësimit në NATO. Ne ishim të vendosur të zgjidhim problemet dhe jo t'i fshehim ato, dhe në fund ia arritëm për të mirën e të gjithë qytetarëve", ka deklaruar Zaev.

Protokolli është votuar edhe nga VMRO-DPMNE-ja opozitare. Nikolla Micevski tha se "VMRO-ja në vazhdimësi ka përkrahur dhe do të përkrahë integrimet euroatlantike, por gjithmonë duke mbajtur llogari edhe për interesat nacionale dhe shtetërore të Maqedonisë".

Protokolli për anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO u nënshkrua një vit më parë në selinë e Aleancës në Bruksel. Më 6 shkurt 2019, pas nënshkrimit të marrëveshjes, ministri i Jashtëm Nikolla Dimitrov tha se Maqedonia e Veriut nuk ishte më vetëm, tani do t'i ketë 29 aleatë. Më pas, shtetet e tjera anëtare të Aleancës ratifikuan protokollin, por për shkak të krizës politike në Spanjë dhe zgjedhjeve, ata ende janë në pritje të dritës së gjelbër.

Maqedonia e Veriut ka bërë një rrugë e gjatë deri në anëtarësimin në NATO. Procesi i anëtarësimit ka nisur në fund të vitit 1993, kur parlamenti pati miratuar një rezolutë për anëtarësimin në Aleancë. Në vitin 1999, në Samitin e Uashingtonit, Maqedonia e Veriut fitoi statusin e shtetit kandidat për anëtarësim të plotë në këtë organizatë.

Në vitin 2008 ajo mori një ofertë për anëtarësim të plotë, por që dështoi për shkak të vetos nga ana e Greqisë për shkak të moszgjidhjes së kontestit të emrit. Pas mosmarrëveshjes gati prej dy dekadave, më 17 qershor të vitit 2018, Shkupi dhe Athina zgjidhën kontestin e emrit me çka Maqedonia mori emrin Maqedonia e Veriut. Pas kësaj Greqia hoqi veton dhe Shkupi nënshkroi një protokoll për anëtarësim në Aleancë. Protokolli është ratifikuar nga të gjitha parlamentet e shteteve anëtare të NATO-së, përveç nga Spanja dhe deri se këtë ta bëjë ky vend, Maqedonia e Veriut do të marrë pjesë në të gjitha organet e Aleancës, por pa të drejtë të votës.

## Kryemadhi takon ambasadoren Yuri Kim

**Tiranë, 11 shkurt** - Kryetarja e Partisë Socialiste për Integrim (LSI) të martën është takuar me ambasadoren e ShBA-së në Tiranë, Yuri Kim. Ajo ka thënë se ka shprehur mbështetjen e plotë për tri prioritetet e ambasadores Yuri Kim në Shqipëri, në fushën e sigurisë, në fushën e forcimit demokratik si dhe në aspektin e bashkëpunimit ekonomik dhe të zhvillimit, për të cilat LSI-ja ndan të njëjtin vizion dhe të njëjtin vlerësim. "Vlerësoj në mënyrë të veçantë theksin në prioritetet e bashkëpunimit ekonomik të cilat janë domosdoshmëri që vendit t'i kthehet një rritje e qëndrueshme ekonomike dhe të ofrojë punësim, veçanërisht për rininë. Vlerësova, gjithashtu, mbështetjen e pakufizuar që ShBA-ja jep për procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian dhe përkrahjen e vazhdueshme për realizimin e reformave që kërkon agjenda jonë e integrimit.

Ndamë bindjen e përbashkët që përfundimi sa më i shpejtë i reformës zgjedhore sipas standardeve të OSBE/ODIHR është i një rëndësie prioritare. Vlerësova partneritetin strategjik me ShBA-në për forcimin e paqes, të zhvillimit dhe të integrimit të rajonit tonë", ka shkruar Kryemadhi.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Ambasadori Richard Grenell shpeshton kërkesat për heqjen e taksës ndaj Serbisë

# Emisari i presidentit Trump ripërsërit kërkesën për heqjen e taksës

Emisari i presidentit Donald Trump për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Richard Grenell, ka ripërsëritur kërkesën e tij ndaj drejtuesve të institucioneve shtetërore për heqjen e taksës 100 për qind ndaj produkteve serbe. Grenelli ka thënë se heqja e taksës do t'u hapte rrugën investimeve në Kosovë dhe Serbi. Përpos kërkesës për heqjen e taksës, Grenelli është deklaruar edhe kundër paralajmërimeve të kryeministrit Albin Kurti për zëvendësimin e taksës me reciprocitet



**Prishtinë, 11 shkurt -** I dërguari i posaçëm i presidentit amerikan Donald Trump për dialogun Kosovë - Serbi, Richard Grenell, të martën ka ripërsëritur kërkesën për heqjen e taksës në mënyrë që t'u hapet rrugë investimeve. Ai në llogarinë e vet në "Twitter" ka shkruar se heqja e taksës është bazike për investime në vendin tonë. "Taksa duhet të hiqet në mënyrë që investimet të zhvillohen. Është bazike", ka shkruar Grenell, duke shpërndarë edhe një status të koordinatorit në Zyrën për Sfidat e Mijëvjeçarit (MCC), Petrit Selimi. "Investime të mëtutjeshme në Kosovë nga MCC-ja planifikuar në buxhetin e Donald Trumpit. Marrëveshja kompakte pritet të sigurojë një nxitje të madhe për infrastrukturën energjetike dhe të mundësojë partneritete publiko-private që sjellin rritje ekonomike në Kosovë", ka shkruar Selimi.

Të hënën zëdhënësi i Grenellit, Dick Custin, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se Grenelli e inkurajon Kosovën që ta heqë taksën 100 për qind ndaj prodhimeve të importuara nga Serbia, pa reciprocitet. "Kosova duhet ta heqë taksën ndaj mallrave të Serbisë, pa reciprocitet. Jo vetëm ta pezullojë, por ta heqë plotësisht atë. Ambasadori nuk e mbështet idenë e reciprocitetit", ka thënë ai. Ndërsa në një intervistë për "HughHewit", emisari i Trumpit ka folur për marrëveshjen e arritur në Berlin për linjën ajrore në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe për takimin e mbajtur në mes të delegacionit nga Prishtina dhe Beogradi për çështjen e hekurudhave.

Grenelli ka thënë se pavarësisht përparimit të bërë, rruga drejt normalizimit të raporteve Kosovë - Serbi është e gjatë. Në këtë kontekst, ka thënë se synimi i vërtetë i Trumpit është ta shfrytëzojë ekonominë për t'i çuar përpara proceset politike. "Kur presidenti Trump më kërkoi ta vërtetoja nëse liderët e Kosovës dhe Serbisë ishin të interesuar për të arritur ndonjë lloj marrëveshje, unë i nisa bisedimet. Takimi im i parë ka qenë me komunitetin e biznesit nga dy palët dhe ajo çfarë kam zbuluar është që ata vërtet dëshironin t'i normalizonin marrëdhëniet në rrafshin ekonomik. Dhe kështu krijuam synimin për mënyrën se si ta normalizojmë tregun. Ajo çfarë kuptuam ishte që të normalizoheshin linja ajrore dhe hekurudhat. Ne donim që të kishim një fluturim të parë Prishtinë - Beograd pas 21 vjetësh. Kështu që e filluam punën për një gjë të tillë dhe ishim në gjendje të arrinim një marrëveshje. Synimi i vërtetë i Trumpit është ta shfrytëzojë ekonominë për t'i çuar përpara proceset politike", ka thënë Grenelli.

Po ashtu, Grenelli ka thënë se pas takimeve që ka pasur në Kosovë dhe Serbi ka parë që palët dëshirojnë normalizim të marrëdhënieve në rrafshin ekonomik. Më tutje, ai ka thënë se po përpiqen t'i shtyjnë palët të pajtohen. "Po mendoj, në stil tipik të administratës së Donald Trumpit, ne po i shtyjmë palët që të pajtohen, dhe po përpiqemi të mos kemi këtë lloj ideje amerikane që është e importuar, por t'i themi presidentit Vuçiq, Thaçit dhe Albin Kurtit, se a e keni vullnetin politik për të ecur përpara, për të krijuar vende pune për të rinjtë dhe për ta ndryshuar ekonominë? Dhe mendoj se përgjigjja është po, edhe pse situata politike është e vështirë. Unë vazhdoj t'u them palëve ne po përpiqemi të koncentrohemi në ekonomi dhe do të provojmë të krijojmë vende pune për të rinjtë në mënyrë që ata të mos largohen nga rajoni. T'i lëmë mënjanë problemet politike derisa ta krijojmë një momentum në ekonomi", ka thënë Grenelli.

Ditë më parë kryeministri Albin Kurti kishte paralajmëruar zëvendësimin e taksës prej 100 përqindësh ndaj Serbisë me reciprocitet. Një paralajmërim i tillë kishte nxitur reagime të fuqishme të partive opozitare, Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Nismës Socialdemokrate. Tre liderët e partive opozitare, Kadi Veseli, Ramush Haradinaj dhe Fatmir Limaj, e kanë kundërshtuar një gjë të tillë, duke vlerësuar se taksa 100 për qind ndaj produkteve serbe është një temë e ndjeshme dhe nuk duhet të bëhen manovrime me të. Më i ashpri në këtë drejtim ka qenë ish-kryeministri Ramush Haradinaj, i cili me fanatizëm e kishte mbrojtur taksën ndaj Serbisë gjatë qeverisjes së tij.

Përmes një letre publike drejtuar Kurtit, në të cilën ia ka përmendur sakrificat e kryeministrit të ri, Haradinaj e kishte lutur Kurtin që të mos e heqë taksën. Edhe kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka kundërshtuar paralajmërimin e Kurtit për heqjen e taksës. Ai kishte thënë se ndihet i shqetësuar për ngutin e tepruar të kryeministrit të ri për t'i përmbushur kërkesat e Serbisë dhe për ta rehatuar Listën Serbe. Pas deklaratave të Veselit, kishte reaguar Grenelli. "Kadri, Shtetet e Bashkuara po kërkojnë që Kosova ta heqë tarifën 100 për qind. Ajo e dëmton Kosovën dhe pengon bizneset për krijimin e vendeve të punës. Albini ka të drejtë për këtë", kishte shkruar Grenelli në "Twitter", ku i menjëhershëm kishte qenë reagimi i Veselit. "Zotëri ambasador, Albini është gënjeshtar. Propozimi im për taksën është shumë i qartë qysh prej janarit 2019. Albini nuk e ka mbështetur dhe ka bërë fushatë kundër tij. Unë jam i shqetësuar me nxitimin e qeverisë së re për t'u marrë me këtë çështje pa një plan konkret, i cili e vendos interesin më të mirë të Kosovës në rend të parë", kishte shkruar Veseli.

Taksa doganore 100 për qind ndaj importeve nga Serbia dhe Bosnje e Hercegovina ishte vendosur në nëntorin e vitit 2018 nga Qeveria e kaluar e Kosovës e ish-kryeministrit Ramush Haradinaj. Ky vendim i qeverisë së kaluar ishte parë më pas si pengesë për vazhdimin e dialogut midis Prishtinës dhe Beogradit, pasi që presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq, ishte tërhequr nga tavolina e bisedimeve, duke e kushtëzuar vazhdimin e dialogut me heqjen e taksës.

## AAK-ja: Do t'i përdorim të gjitha mjetet demokratike për mbajtjen e taksës 100 për qind




**Prishtinë, 11 shkurt -** Grupi parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës ka mbajtur një mbledhje për të diskutuar për hapat e mëtutjeshëm që ky grup parlamentar do t'i ndërmarrë për taksën 100 për qind. Gazmend Abrashi, deputet i AAK-së, ka thënë se partia që ai përfaqëson do të argumentojë pse taksa duhet të qëndrojë. "Aleanca do t'i përdorë gjitha mjetet demokratike për ta vazhduar mbajtjen e taksës. Ne do të vazhdojmë të punojmë me komunitetin e biznesit që t'i sjellim argumentet pse taksa duhet të qëndrojë", ka thënë Abrashi.

Më tutje, ai ka theksuar se AAK-ja është për ndërtimin e autostradës së Dukagjinit. "Ne jemi për ndërtimin e autostradës së Dukagjinit. Ne duhet të kuptojmë se shteti nuk qëndron nga një qeveri. Këto projekte nuk mund të hiqen pa ndonjë konsultim paraprak. Qeveria e kaluar ka vendosur disiplinë financiare dhe mundësohet vazhdimi i këtyre projekteve", është shprehur Abrashi.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka realizuar vizitën e parë zyrtare në Shqipëri

# Kryeministrat pajtohen për një fillim të fuqishëm të bashkëpunimit Kosovë - Shqipëri




Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama dhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, janë marrë vesh për një fillim të fuqishëm të bashkëpunimit Kosovë - Shqipëri. Gjatë vizitës së tij të parë zyrtare në Shqipëri, kryeministri Kurti ka thënë se Kosova dhe Shqipëria janë prioritet i njëra-tjetrës dhe nuk janë çështje që presin në asnjë fushë. Krerët e dy qeverive janë pajtuar ta formojnë një komision ndërshtetëror, i përbërë nga ministra dhe deputetë, që të sigurohen se 77 marrëveshjet e nënshkruara nga qeveritë e dy vendeve duhet të zbatohen dhe të arrihen marrëveshje të reja. Megjithatë, ata kanë shprehur mendime të ndryshme për minishengenin ballkanik

EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 11 SHKURT - Vizitën e parë jashtë vendit kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka realizuar në Shqipëri, ku është pritur me nderime të larta shtetërore nga kryeministri shqiptar Edi Rama. Kryeministrat e të dy shteteve, në një konferencë të përbashkët për media, janë pajtuar për një shpejtësi të re të bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë. Rama dhe Kurti janë marrë vesh për krijimin e një komisioni ndërshtetëror për rishikimin dhe zbatimin e marrëveshjeve që janë nënshkruar deri tani mes dy vendeve në mbledhjet e përbashkëta të qeverive. "Do të vendosim në funksion një komision ndërshtetëror të përbërë nga ministra dhe përfaqësues të komisioneve parlamentare për ta ndjekur ecurinë e marrëveshjeve, për t'i identifikuar problematikat në zbatimin e tyre dhe për t'i adresuar në mbledhjen e të dy qeverive në funksion qoftë të arritjeve, qoftë të nevojave për vendimmarrje të tjera", ka thënë kryeministri shqiptar Edi Rama.

Ai ka thënë se me kryeministrin Kurti ka diskutuar edhe për rëndësinë e procesit të Berlinit dhe për katër liritë themelore të Bashkimit Evropian. "Kemi diskutuar me kryeministrin edhe për procesin e Berlinit dhe vazhdojmë të flasim për t'i harmonizuar veprimet dhe hapat në funksion të nismës për implementimin e katër lirive themelore të Bashkimit Evropian në rajonin tonë, e që për ne bashkëpunimi me Kosovën mbetet prioritet i prioriteteve. E kam thënë edhe më parë, ia thashë edhe kryeministrit sot, po e them edhe këtu publikisht përsëri, që për mua, nëse nuk realizojmë lëvizjen e plotë të lirë të njerëzve në radhë të parë, pastaj edhe lëvizjen e plotë të mallrave, të kapitaleve dhe shërbimeve, nuk e kemi kryer detyrën tonë ndaj të ardhmes dhe njerëzve tanë", ka deklaruar Rama.

Ndërsa kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka deklaruar se dëshira e tij është që vendet të kenë një fillim të fuqishëm të bashkëpunimit. Kurti është shprehur se Kosova dhe Shqipëria janë prioritet i njëra-tjetrës dhe nuk janë çështje që presin në asnjë fushë. "Unë dua që në dekadën e tretë të shekullit XXI të kemi një fillim të fuqishëm të bashkëpunimit Kosovë - Shqipëri çfarë nuk ka pasur asnjëherë midis dy vendeve tona. Pra, Kosova dhe Shqipëria janë prioritet i njëra-tjetrës dhe nuk janë çështje që presin në asnjë fushë. U morëm vesh, siç e tha edhe kryeministri Rama, që të formojmë një komision ndërshtetëror, i përbërë edhe nga ministra dhe

## Haxhiu takohet me përfaqësuesit e shoqërisë civile

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Ministrja e Drejtësisë (MD), Albulena Haxhiu, ka pritur të martën në takim përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të cilët kanë qenë zëri më i fuqishëm në kundërshtimin e emërimit të noterëve të përzgjedhur në procedurë të dyshimtë, duke kërkuar një rishikim të plotë të këtij procesi. Gjatë këtij takimi ministrja Haxhiu ka përgëzuar përfaqësuesit e shoqërisë civile për insistimin dhe konsistencën e tyre për pengimin e këtij procesi të komprometuar dhe të dyshimit i cili duhet të kthehet në pikën zero. Sipas ministres Haxhiu, ka qenë pikërisht reagimi i shoqërisë civile ai i cili ka bërë që kundër këtij procesi të dalin edhe një numër institucionesh dhe organizatash ndërkombëtare. Në anën tjetër, përfaqësuesit e



këtyre organizatave kanë falënderuar Haxhiun për angazhimin e saj në cilësinë e deputetes dhe kryetares së Komisionit për Legjislacion, për trajtimin e çështjes së noterëve dhe njëherësh kanë kërkuar që urgjentisht ta fillojë rishikimin e gjithë këtij procesi. Haxhiu, pasi ka dëgjuar shqetësimet dhe rekomandimet e secilit nga këta përfaqësues lidhur me procesin e noterisë, ka premtuar se shumë shpejt do të fillojë rishikimi i gjithë procesit dhe do të shqyrtohen të gjitha mundësitë për ta kthyer këtë proces në pikën zero. Po ashtu, gjatë takimit janë adresuar edhe disa çështje të tjera në lidhje me problemet e caktuara në lidhje me: Ligjin për Sinjalizuesit, Ligjin e Kodit të Procedurës Penale si dhe nevojën për hartimin e Rregullores për mbrojtjen e sinjalizuesve. Me këtë rast Haxhiu u ka garantuar përfaqësuesve të shoqërisë civile transparencë dhe bashkëpunim për hartimin e politikave të MD-së.



# Mbledhja e ardhshme e dy qeverive do të mbahet në Shkodër

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, ka treguar se me kryeministrin e Kosovës, Albin Kurti, janë marrë vesh se mbledhja e ardhshme e dy qeverive shqiptare do të mbahet në Shkodër. "Mbledhja e dy qeverive do të mbahet në Shkodër, ndërsa në mes dy mbledhjeve do të bëhet një komision për ta ndjekur ecurinë e marrëveshjeve dhe problematikat e marrëveshjeve në mënyrë që të adresohen në mbledhjen e dy qeverive", ka deklaruar Rama.

deputetë, që ato 77 marrëveshje që janë nënshkruar deri më tani të zbatohen, por edhe të shtohen me marrëveshje të reja", ka deklaruar Kurti.

Ai ka vlerësuar se Kosova dhe Shqipëria duhet të bashkëpunojnë me një ritëm më të shpejtë, sidomos në fushat që i kanë prioritet. "Duam që ta shtojmë bashkëpunimin, ta shtojmë bashkërendimin duke e thelluar e duke e zgjeruar atë. Me këtë rast, dua ta falënderoj Republikën e Shqipërisë dhe popullin shqiptar për ndihmën, përkrahjen e pakursyer dhe të parezervë për Kosovën. Kosova nuk do t'ia dilte me sukses karshi Serbisë në luftë por, po ashtu, as në paqe pa Shqipërinë. Andaj, ne kurrë nuk e harrojmë këtë gjë dhe duam që në shekullin XXI të ecim bashkë, shpejt, fuqishëm. Në veçanti duam që të bashkëpunojmë në aspektin ekonomik, të prodhimtarisë, të arsimit, të sigurisë e të politikës së jashtme. Besojmë se këto janë fusha në të cilat i kemi shqetësimet e njëjta dhe, gjithashtu, partnerët e aleatët tanë demokratikë të zhvilluar e perëndimorë, janë po të njëjtit", ka thënë Kurti, duke shtuar se beson se do ta dëshmojnë se si dy kryeministra të dy shteteve do ta avancojnë bashkëpunimin shtetëror në fusha dhe përmasa çfarë i ka dëshiruar gjithmonë kombi, por ende nuk i ka parë.

## Minishengeni ballkanik i ndanë Kurtin dhe Ramën

Ndonëse janë pajtuar për të dinamizuar bashkëpunimin në mes të dy vendeve, kryeministri Rama dhe kryeministri Kurti nuk janë pajtuar rreth idesë për minishengenin ballkanik. I pyetur nga gazetarët për këtë çështje, Kurti ka thënë shkurt se ky takim ishte më shumë për makroshengenin shqiptar sesa për minishengenin ballkanik. "Kjo ishte një temë që e trajtuam por, shkurtimisht, meqenëse takimi ynë i parë sot ishte, le të themi, për makroshengenin shqiptar sesa për minishengenin ballkanik", ka thënë Kurti. Kurse kryeministri Rama ka deklaruar se s'mund të ketë makroshengen shqiptar pa minishengen ballkanik. "Unë besoj se makroshengeni shqiptar është i lidhur ngushtësisht me minishengenin rajonal sepse nëse ne jemi konsistentë në vazhdën e procesit të Berlinit dhe nëse ne jemi të harmonizuar në ndërveprimin tonë, çka e kemi diskutuar, atëherë na hapet rruga që është e mbyllur prej të gjitha viteve, për të pasur një hapësirë të përbashkët mes dy shteteve", ka thënë Rama. Sipas tij, duke thyer këtë rezistencë askush, as Serbia, nuk do të thotë se po bëjmë Shqipërinë e madhe nëse heqim kufirin.

## Kurti takon Metën dhe Bashën

Gjatë vizitës në Tiranë, Kurti ka takuar edhe presidentin e Shqipërisë, Ilir Meta dhe kryetarin e PD-së, Lulzim Basha. Përmes një postimi në profilin e vet në "Facebook", Meta ka shkruar se qeveria e Kurtit i ka të gjitha mundësitë të jetë një shembull pozitiv i mirëqeverisjes në rajon. "Shumë i lumtur të prisja sot në një takim të përzemërt Kryeministrin e Republikës së Kosovës, Sh.T.Z Albin Kurti. E urova për marrjen e detyrës së lartë dhe për sa më shumë suksese në të mirë të Kosovës, të popullit të saj dhe të ardhmes sonë evropiane. Qeveria e tij i ka të gjitha mundësitë të jetë një shembull pozitiv i mirëqeverisjes në rajonin tonë. Duhet ta konkretizojmë Partneritetin Strategjik me Kosovën, duke e bërë atë një model dhe inkurajim për bashkëpunimin rajonal", ka shkruar Meta.

Më pas, shefi i Qeverisë së Kosovës ka zhvilluar një takim edhe me kryetarin e Partisë Demokratike, Lulzim Basha, i cili ka thënë se opozita e Shqipërisë i ka prioritetet e qarta sa i përket bashkëpunimit me Kosovën. "Ne do të bëjmë gjithçka për të ndihmuar në tregtinë e lirë, në integrimin ekonomik të Shqipërisë dhe Kosovës, për t'u dhënë shanse për punësim qytetarëve tanë e në veçanti rinisë; për ta ndalur shpopullimin që është produkt i drejtpërdrejtë i korrupsionit dhe i kapjes së shtetit nga krimi i organizuar, sikur edhe për angazhimin tonë sot dhe nesër për ta vazhduar mbështetjen nga Republika e Shqipërisë për Republikën e Kosovës", ka thënë Basha. Gjatë vizitës në Shqipëri, Kurti ka takuar edhe kryetarin e Kuvendit të Shqipërisë, Gramoz Ruçi.





# Tahiri i PDK-së e quan Kurtin politikan të paftë për të qeverisur

**PRISHTINË, 11 SHKURT (ER)** - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Abelard Tahiri, ka thënë se është e çuditshme dhe e paprecedent se si qeveria e udhëhequr nga Albin Kurti, edhe pas një jave të formimit të saj, ende nuk e ka mbajtur mbledhjen e parë dhe ende nuk e ka shpalosur para qytetarëve programin qeverisës. Ai ka thënë se në vend të kësaj Kurti ka zgjedhur ta bëjë një vizitë jashtë vendit. Sipas tij, ky fakt është tregues i qartë se kemi të bëjmë me një politikan të paaftë për ta kuptuar dhe administruar ekzekutivin. "Prioritet i kryeministrit sot nuk ishte takimi me kabinetin e tij, për t'i përcaktuar detyrat themelore, e as ofrimi i programit që do të shërbente për ta njohur orientimin politik, ekonomik e social ndaj temave kryesore e zhvillimore të vendit, por një vizitë në Shqipëri. Por, kjo vizitë e tij, përderisa ende nuk ka ushtruar as funksionin themelor të kryeministrit, është një paralajmërim tipik i stilit të tij politik të papërgjegjësisë dhe mashtrimit, të cilin ai përpiqet të na e shesë si punë të rëndomtë të një kryeministri. Është shqetësuese sjellja e papërgjegjshme e Kurtit karshi pritjeve të qytetarëve, që me të drejtë kërkojnë ta dinë agjendën e prioriteteve për Kosovën", ka shkruar Tahiri në "Facebook".


Visar Kryeziu (AP)

# Filloi implementimi i projektit QUADIC




GJILAN, 11 SHKURT (ER)- Në Universitetin "Kadri Zeka" në Gjilan ka nisur implementimi i projektit QUADIC - Quality development of international cooperation and project management, projekt ky i fituar nga UKZ-ja në programin Erasmus + Cooperation for Innovation and the exchange of good Practices, në thirrjen e fundit Capacity Building in Higher Education - Joint Projects.

Në aktivitetin e parë që ka filluar të martën me Kick Off Meeting, organizuar nga Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar, e që do të zgjasë deri më 14 shkurt, po marrin pjesë të gjithë partneret vendorë dhe ndërkombëtarë, gjithsejtë 18 përfaqësues të institucioneve. Hapjen e fillimit të implementimit të projektit e bëri rektori i Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, prof. asoc. dr. Bajram Kosumi, i cili fillimisht ka falënderuar prorektorin për bashkëpunim ndërkombëtar të UKZ-së, prof. ass. dr. Dukagjin Leka, njëherësh koordinator i projektit QUADC, për punën e vazhdueshme për ndërkombëtarizimin e universitetit dhe të gjithë partnerët pjesëmarrës në këtë projekt, duke thënë se ndihet i lumtur që sot po fillon një projekt kaq madhor. Më pas rektori Kosumi ka paraqitur një prezantim të UKZ-së për punën, aktivitetet, zhvillimet dhe synimet për të ardhmen.

Ndërsa rektori i Universitetit të Gjakovës "Fehmi Ahani", prof. ass. dr. Artan Nimani, ka uruar të gjithë për fillimin e projektit, duke e vlerësuar mjaft të rëndësishëm dhe të nevojshëm bashkëpunimin e ndërsjellë të të gjithë pjesëmarrësve në QUADIC. Kurse rektori i Universitetit të Prizrenit "Ukshin Hoti", prof. asoc. dr. Ismet Temaj, ka pohuar se angazhimi i shkëlqyeshëm që është bërë në punën e QUADIC-it është për t'u admiruar sepse sot së bashku gjithë pjesëmarrësit mund të kontribuojnë për realizimin sa më të mirë të tij.

Qamile Sinanaj nga MAShT-i ka falënderuar të gjithë partnerët që mbështesin çdo projekt edukativ. Projekti QUADIC është i pari i këtij lloji në Kosovë që ka të bëjë me ngritjen e kapaciteteve për projektet ndërkombëtare, ku Universiteti "Kadri Zeka" në Gjilan në thirrjen e fundit të programit Erasmus + ka aplikuar si koordinator, duke u pranuar suksesshëm.

# Aktakuzë për rrezikimin e sigurisë në vendin e punës




PEJË,11 SHKURT (ER) - Prokuroria Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurit I. C. për veprën penale "Asgjësimi, dëmtimi ose heqja e pajisjeve mbrojtëse dhe rrezikimi i sigurisë në vendin e punës", nga neni 358, paragrafi 2 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Sipas aktakuzës, i pandehuri I. C., në cilësinë e pronarit të kompanisë "Gogaj AG" në Deçan, më 29 gusht 2019 nuk vepron në pajtim me dispozitat apo rregullat teknike mbi masat për sigurinë e vendit të punës, në atë mënyrë, derisa punëtori i kësaj kompanie, i dëmtuari V. Ç., ishte në depon e kompanisë në fjalë për tërheqjen e një dush-kabine, në momentin kur i dëmtuari tërheq paketimin, anojnë edhe disa paketime të tjera, me ç'rast e godasin të dëmtuarin duke i shkaktuar lëndime trupore. Me këto veprime ekziston dyshimi i bazuar mirë se i pandehuri ka përmbushur elementet e veprës penale të përshkruar si më lart.

Prokurori i çështjes me rastin e ngritjes së aktakuzës i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit për veprën penale e cila i vihet në barrë.

# KQZ-ja kufizon shpenzimet e subjekteve politike për fushatën zgjedhore në Podujevë

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka mbajtur mbledhjen e radhës të kryesuar nga anëtari i KQZ-së, Alim Rama. Në këtë mbledhje KQZ-ja mori vendim për kufizimin e shpenzimeve të fushatës zgjedhore për subjektet politike që do të marrin pjesë në zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Podujevës.

Nëpërmjet këtij vendimi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përcakton kufirin e sipërm të shpenzimeve të fushatës zgjedhore për subjektet politike që do të certifikohen për pjesëmarrje në këto zgjedhje, në shumën 43 433 euro. Ky kufizim mbështetet në Rregullën Zgjedhore nr. 12/2013, sipas së cilës, kufizimi i shpenzimeve të fushatës do të jetë 0.50 euro për votues të regjistruar. Sipas listës jopërfundimtare të regjistrit civil, numri i votuesve në Komunën e Podujevës është 86 866 votues të regjistruar.



## AGK-ja siguron zyrat pa kosto financiare

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Ndërmarrja Publike Banesore së bashku me Komunën e Prishtinës edhe sivjet kanë siguruar dy zyra për funksionimin e Asociacionit të Gazetarëve të Kosovës (AGK), organizatës më përfaqësuese të komunitetit të gazetarëve në vend. Marrë parasysh se veprimtaria e AGK-së është e varur nga donatorët dhe partnerët kryesisht ndërkombëtarë dhe duke parë nevojën për hapësirë adekuate, që nga gushti i vitit 2019 NPB ia ka mundësuar AGK-së, zhvendosjen në objektet e reja, duke e liruar nga pagesa e qirasë.

Më parë, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës kishte paguar rreth 400 euro qira mujore në një objekt privat. AGK-ja shpreh falënderim për ndihmën dhe korrektësinë e drejtuesve të Ndërmarrjes Publike Banesore dhe Komunës së Prishtinës, të cilët përmes kësaj marrëveshjeje kanë lehtësuar punën dhe funksionimin e AGK-së. AGK-ja shprehet e përkushtuar për respektimin e marrëveshjes dhe shpreh gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit edhe gjatë viteve të ardhshme.



Ministri i Jashtëm i Italisë, Luigi Di Maio, takohet me drejtuesit e institucioneve shtetërore të Kosovës

# Kryediplomati italian kërkon nga Kosova t'i rikthehet dialogut

**Ministri i Jashtëm i Italisë, Luigi Di Maio, gjatë vizitës zyrtare në Kosovë ka thënë se shteti italian përkrah institucionet shtetërore të Kosovës për reforma, zhvillim ekonomik dhe krijim të perspektivës për të rinjtë e vendit. Po ashtu, ai ka thënë se Italia mbështet heqjen e vizave për qytetarët e Kosovës. Ndërsa sa i përket çështjes së normalizimit të marrëdhënieve në mes të Prishtinës dhe Beogradit, Di Maio ka bërë thirrje që Kosova t'i kthehet dialogut me Serbinë në mënyrë që të hapet rruga drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian (BE). "Italia nxit dialogun e paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë", ka thënë Di Maio**




EPOKA E RE — Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Ministri i Jashtëm i Italisë, Luigi Di Maio, ka vizituar Republikën e Kosovës, ku është pritur në takime të ndara me përfaqësuesit kryesorë të institucioneve shtetërore. Fillimisht ministri Di Maio është takuar me homologun Glauk Konjufca. Pas takimit të dy ministrat kanë mbajtur një konferencë të përbashkët për medie. Me këtë rast, ministri i Punëve të Jashtme, Glauk Konjufca, ka deklaruar se Italia mbetet mbështetësja e palëkundur e Kosovës drejt integrimit në Bashkim Evropian (BE). Më tutje, Konjufca ka thënë se me homologun italian kanë diskutuar për bashkëpunimin ekonomik ndërmjet dy vendeve si dhe për teknologjinë informative. Ai ka theksuar se Italia po e ndihmon Kosovën në heqjen e vizave dhe anëtarësim në NATO. "Patëm një takim të shkëlqyeshëm me ministrin Di Maio. Jemi të gëzuar që po e viziton Kosovën. E falënderova edhe një herë për rolin që e ka pasur në çdo fazë të shtetndërtimit të Kosovës dhe jo vetëm thjesht kur ishte shpallja e pavarësisë, por edhe në faza të mëhershme të rëndësishme kur populli i Kosovës luftonte për arritjen e lirisë", ka thënë Konjufca. Ndërsa ministri i Jashtëm i Italisë, Luigi Di Maio, ka bërë thirrje që Kosova t'i kthehet dialogut me Serbinë në mënyrë që të hapet rruga drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. "Të rinjtë shohin për mundësi për të ardhmen dhe ajo është edhe teknologjia e re. Kjo mund t'i bashkojë gjeneratat për ta ndaluar migrimin e të rinjve. Italia nxit dialogun e paqes në mes të Kosovës dhe Serbisë. Në këtë aspekt do të bëjmë që edhe Bashkimi Evropian të jetë protagonist dhe lehtësues i dialogut që do t'i japë përparësi integrimit evropian", është shprehur ai.

Kryediplomati italian gjatë vizitës zyrtare në Kosovë është takuar me kryeministrin Albin Kurti, i cili ishte kthyer nga Tirana për ta pritur në zyrë mysafirin nga Italia. Kurti e Di Maio janë pajtuar se dialogu në mes të Kosovës dhe Serbisë duhet të sjellë paqe ndërmjet dy shteteve.

**Osmani, kryediplomatit italian: Perspektiva evropiane, orientim strategjik i popullit të Kosovës**

Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim ministrin e Jashtëm të Italisë, Luigi Di Maio, me të cilin ka diskutuar për çështjet e bashkëpunimit dypalësh si dhe për procesin e integrimit të rajonit në Bashkim Evropian (BE). Ajo ka shprehur mirënjohjen e popullit dhe të institucioneve të Republikës së Kosovës për ndihmën që Italia, si vend mik, ia ka ofruar Kosovës në periudhat më të vështira të saj, por po vazhdon t'ia ofrojë edhe në kohën e konsolidimit të shtetësisë së saj. "Kemi plane shumë ambicioze për zhvillim. Duam që pritjet e qytetarëve tanë t'i realizojmë me përpikëri, prandaj kemi nevojë për thellim të partneritetit me miqtë tanë", ka thënë Osmani. Sipas saj, perspektiva evropiane është orientim strategjik i popullit të Kosovës. "Përcaktimi ynë për integrim në strukturat euroatlantike mbetet synim jetik i popullit të Kosovës", ka deklaruar Osmani. Ndërsa ministri Di Maio, pasi ka shprehur urimet për përzgjedhjen e Osmanit në krye të institucionit më të lartë përfaqësues, ka theksuar se lidhjet me Kosovën, si vend me të cilin i lidh brezi mediteran, janë të shumëfishta dhe se Qeveria e Italisë dhe ai si ministër i Jashtëm dëshirojnë që raportet e mira ndërmjet dy vendeve të thellohen edhe më tej. Më tutje, ai ka ftuar kryeparlamentaren Osmani që ta vizitojë së shpejti Italinë. Di Maio ka thënë se Italia përkrah institucionet e Republikës së Kosovës në synimin e tyre për reforma, zhvillim ekonomik dhe krijim të perspektivës për të rinjtë e vendit. "Investimi në teknologjitë e reja është një mënyrë për t'ua siguruar të ardhmen të rinjve të Kosovës", ka thënë ministri Di Maio.



# Reka në takim me Apostolovën thekson rëndësinë e finalizimit të procesit

EPOKA E RE — Qendresa Rama



PRISHTINË, 11 SHKURT- Ministri i Integrimit Evropian, Blerim Reka, është takuar të martën me shefen e Zyrës së BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, e cila ia ka uruar detyrën e re, duke shprehur gatishmërinë e zyrës që drejton për ta mbështetur integrimin evropian të Kosovës. Me këtë rast, Reka ka theksuar se prioritet i qeverisë Kurti do të ketë përkushtimi për zbatimin e agjendës evropiane. Në aspektin afatshkurtër, ministri i Integrimit Evropian potencoi rëndësinë dhe domosdoshmërinë për ta finalizuar liberalizimin e vizave për qytetarët e Kosovës si një çështje shumë gjatë e prolonguar. Po ashtu, ai ritheksoi zotimet e qeverisë Kurti se do t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme për sigurimin e zbatimit të sundimit të rendit dhe ligjit si komponentat kryesore që kontribuojnë në këtë drejtim.

Reka dhe Apostolova u pajtuan që të punojnë në një agjendë të përbashkët si dhe ta shtojnë koordinimin teknik dhe profesional me Ministrinë e Integrimit Evropian si institucion përgjegjës për koordinimin e procesit të integrimit evropian në nivel vendi. Apostolova theksoi se "Ministria e Integrimit Evropian është partnerja kryesore e BE-së në qeveri". Ajo ka shtuar se duhet të jetë në qendër të qeverisë, duke udhëhequr ministritë e linjës për t'i çuar përpara reformat evropiane të Kosovës.

## PDK-ja shpall zgjedhjet për Forumin e Gruas

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) edhe zyrtarisht e ka shpallur të hapur procesin e zgjedhjeve të brendshme në Forumin e Gruas. Në një takim të mbajtur në mes të kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli dhe strukturave të tjera drejtuese të partisë, ky proces është konsideruar i domosdoshëm për forcimin e mëtutjeshëm të gruas në jetën publike. "PDK-ja gjithnjë ka qenë e angazhuar për rolin e gruas në vendimmarrje brenda partisë dhe do ta kemi prioritet të vazhdueshëm, duke krijuar hapësirë për gratë në PDK. Kjo do të krijonte hapësirë për një proces demokratik e përmbajtjesor dhe forcim të rolit të gruas në vendimmarrje", ka thënë Veseli. Kurse udhëheqësja e Departamentit për Politika Gjinore në PDK, Blerta Deliu Kodra, u ka bërë thirrje grave dhe vajzave që të bëhen pjesë aktive e këtij procesi zgjedhor në Gruan Demokratike. Në anën tjetër, sekretari i përgjithshëm i PDK-së, Uran Ismaili, ka thënë se misioni për përfaqësim të gruas është mision për zhvillim shoqëror. "PDK-ja e ka këtë mision për demokracinë dhe për zhvillimin shoqëror", ka thënë Ismaili.



# Kosova dhe Emiratet e Bashkuara Arabe shkëmbejnë përvojat në fushën e auditimit

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Auditori i Përgjithshëm i Kosovës (ZKA), Besnik Osmani, ka pritur të martën në takim presidentin e Institucionit Shtetëror të Auditimit të Emirateve të Bashkuara Arabe, Harib Saeed Al Amimi.
Në takim është diskutuar për shtimin e bashkëpunimit bilateral me qëllim të shkëmbimit të informatave dhe përvojave, në interes të avancimit të mëtejmë të auditimit të jashtëm dhe përmirësimit të menaxhimit të parasë publike. Osmani e ka njoftuar homologun arab për punën dhe rezultatet e Zyrës Kombëtare të Auditimit si dhe për ndikimin e rekomandimeve për ta rritur llogaridhënien dhe qeverisjen e mirë të institucioneve. Ai e ka falënderuar mysafirin i cili në vazhdimësi e ka përkrahur Zyrën Kombëtare të Auditimit edhe për kontributin e dhënë në procesin e anëtarësimit të ZKA-së në INTOSAI.
Ndërsa Al Amimi ka bërë me dije se e përcjellë në vazhdimësi punën e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Kosovës, me ç'rast ka përgëzuar Osmanin për arritjet e deritanishme. Ai ka thënë se me anëtarësimin në INTOSAI, ZKA-së do t'i mundësohet shkëmbimi i njohurive dhe përvojave me Institucionet Supreme të Auditimit simotra. "Institucioni Suprem i Auditimit i Emirateve të Bashkuara Arabe ka një përvojë të madhe në organizimet dhe projektet ndërkombëtare në fushën e auditimit, duke qenë se për tri vjet (2016-2019) ka drejtuar INTOSAI-n. Ky takim u realizua në kuadër të vizitës së dr. Harib Saeed Al Amimi në Kosovë për të marrë pjesë në Konferencën Ndërkombëtare 'Domethënia dhe rëndësia e anëtarësimit në INTOSAI: ndikimi dhe përfitimet për Institucionet Supreme të Auditimit'. Kjo konferencë do të mbahet me rastin e anëtarësimit të Zyrës Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës me të drejta të plota në Organizatën



Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (INTOSAI). Gjatë qëndrimit në Prishtinë delegacioni nga Arabia Saudite do të takohet me përfaqësues të Kuvendit, Qeverisë dhe organizatave të shoqërisë civile", ka njoftuar ZKA-ja.

# ATK-ja identifikon 200 biznese që bëjnë shmangie të tatimit

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Departamenti i operacioneve në Administratën Tatimore të Kosovës (ATK) ka ndërmarrë hapa konkretë ndaj të gjithë tatimpaguesve të cilët, pavarësisht zhvillimit të aktiviteteve biznesore, nuk e kanë paguar tatimin. Sipas njoftimit të ATK-së, janë duke u monitoruar 200 biznese për shmangie tatime. "Identifikimi i këtyre bizneseve është bërë nga analiza e riskut, bazuar në planin e trajtimit të rreziqeve. Aktualisht janë duke u trajtuar 200 raste, të cilat nuk kanë paguar tatimet në raport me




qarkullimin e deklaruar. Këta tatimpagues dhe gjithë të tjerët të cilët nuk paguajnë saktë tatimet do të jenë në monitorim të vazhdueshëm dhe nëse qasja e tyre nuk ndryshon - vazhdojnë me mospërmbushje, ATK-ja do të bëjë vlerësim të gjendjes për ta konstatuar shmangien tatimore dhe njëkohësisht do të bëjë edhe ngritje të kallëzimit penal, varësisht nga të gjeturat dhe shkeljet e konstatuara", është thënë në njoftimin e ATK-së. Sipas këtij njoftimi, këto aktivitete janë duke u ndërmarrë në vazhdën e shumë aktiviteteve të tjera me qëllim të zvogëlimit të shmangies tatimore, si dhe krijimin e një tregu konkurrent për gjithë tatimpaguesit. "Prioritet i Administratës Tatimore vazhdon të mbetet trajtimi i barabartë i të gjithë tatimpaguesve si dhe rritja e llogaridhënës nga stafi i ATK-së, në drejtim të rritjes së kualitetit të punës. ATK inkurajon tatimpaguesit që t'i kryejnë detyrimet tatimore, në të kundërtën do të ndërmerren masat ndëshkuese të përcaktuara me legjislacionin tatimor", ka njoftuar ATK-ja.

# OAK kërkon krijimin e Gjykatës Ekonomike

PRISHTINË, 11 SHKURT - Mungesa e Gjykatës Ekonomike dhe problemet me përmbaruesit ishin ndër temat kryesore të diskutimit ndërmjet përfaqësuesve të Odës së Afarizmit të Kosovës (OAK) me ministren e Drejtësisë, Albulena Haxhiu.
Kryetari i bordit të OAK-së, Skënder Krasniqi, ka uruar ministren Hoxha për pozitën dhe ka shprehur bindjen që së bashku mund të ndikojnë në përmirësimin e klimës së të bërit biznes në vend. Krasniqi ka theksuar se një nga problemet kryesore me të cilin po përballen bizneset është mungesa e Gjykatës Ekonomike, e cila po ndikon që lëndët të zvarriten dhe po pengon ardhjen e investitorëve të huaj. "Prandaj OAK-u konsideron se aktivizimi i saj është i domosdoshëm", ka thënë ai. Haxhiu ka falënderuar Odën për vizitën dhe ka shtuar se themelimi i Gjykatës Ekonomike është kompetencë e Ministrisë së Drejtësisë dhe do të trajtohet me prioritet.



# Universiteti i Prishtinës që nga sot në pullë postare

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 11 SHKURT - Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", për nder të themelimit të Universitetit të Prishtinës, ka promovuar pullën postare me logon e 50-vjetorit. Promovimin e kësaj pulle e ka bërë Posta e Kosovës me rastin e shënimit të pesë dekadave të themelimit të Universitetit të Prishtinës si institucioni më i rëndësishëm arsimor, shkencor dhe kulturor në Republikën e Kosovës.
Rektori i Universitetit të Prishtinës, Marian Dema, ka thënë se promovimi i kësaj pulle postare është aktivitet i rëndësishëm për Universitetin e Prishtinës si shpërblim i punës së madhe të këtij universiteti. "Sot është aktiviteti i tretë që do të promovohet pulla postare, 50-vjetori i Universitetit të Prishtinës. Kjo pullë postare vjen si shpërblim i punës së madhe që ka bërë Universiteti i Prishtinës për 50 vjet. Kjo është një vlerë e veçantë, që besoj se është edhe një vlerë e veçantë për Postën e Kosovës sepse e nderon një tempull i cili për 50 vjet ka dhënë dritë, ka dhënë profesionistë, ka dhënë kontribute në të gjitha fushat", ka thënë Dema.
Dema ka shtuar se shtetin e Kosovës e ka lindur ky universitet, prandaj është i lidhur ngushtë me fatin e popullit të Kosovës dhe është obligim për secilin që ta rrisë dhe zhvillojë atë. "Historikisht fati i Universitetit të Prishtinës ka qenë i lidhur ngushtë me fatin e popullit të Kosovës. Por, jo vetëm kaq. Ndoshta nuk është edhe e rëndësishme që këto dy data, data e themelimit të Universitetit të Prishtinës dhe data e pavarësisë, janë kaq afër, që do të thotë se këtë shtet e ka lindur ky universitet dhe e kemi obligim ta rrisim, ta zhvillojmë dhe ta bëjmë një shtet që do të jetë i këndshëm, që do t'i trajtojë të gjithë në mënyrë të barabartë, në të cilin çdonjëri mund ta realizojë ëndrrën e vet", u shpreh Dema.



Kryeshefi ekzekutiv i postës së Kosovës, Shefqet Avdija, ka thënë se janë krenarë që kanë bërë promovimin e pullës postare për Universitetin e Prishtinës me qëllim të promovimit të vlerave në Republikën e Kosovës. Avdija ka deklaruar se historia e Universitetit të Prishtinës është e pandashme me historinë e popullit, andaj edhe kjo pullë postare do të udhëtojë kudo nëpër botë me imazhin e tempullit të arsimit si institucioni më i rëndësishëm në Kosovë. "Që nga themelimi historia e këtij universiteti mbetet e pandashme me historinë e popullit të Kosovës. Universiteti i Prishtinës, për dallim nga universitetet e Evropës, veprimtarinë e ka zhvilluar në dy fronte: atë të luftës për dije dhe atë të luftës për liri. Kjo dëshmoi edhe një herë se shkolla, arsimi dhe dija janë parakushte për ndërtimin e lirisë shpirtërore si hapa të parë për realizimin e lirisë fizike, prandaj kjo pullë postare do të udhëtojë kudo nëpër botë me imazhin e tempullit tonë të arsimit dhe të dijes", ka deklaruar Avdija.
UP-ja u themelua me Ligjin mbi themelimin e Universitetit të cilin e miratoi Kuvendi i ish-Krahinës Socialiste të Kosovës më 18 nëntor 1969. Kuvendi themelues i Universitetit "Hasan Prishtina" u mbajt më 13 shkurt 1970, ndërsa më 15 shkurt 1970 u mbajt mbledhja solemne e Kuvendit dhe kjo datë u shpall Dita e Universitetit të Prishtinës.

# Mbi 1 milion e 500 mijë euro dëme nga erërat në Istog



ISTOG, 11 SHKURT (ER) - Erërat e fuqishme që kapluan Komunën e Istogut javën e shkuar shkaktuan dëme të mëdha në bujqësi, infrastrukturë rrugore, ndërtesa publike komunale, objekte shëndetësore si dhe në objekte private. Pas krijimit të komisioneve nga ana e kryetarit të Komunës së Istogut, Haki Rugova, për vlerësimin e këtyre dëmeve të shkaktuara si pasojë e erës së fortë, Komuna e Istogut ka dalë me vlerësime të përafërta që këto dëme shkojnë deri në 1 milion e 500 mijë euro. "Dëmet më të mëdha janë në sektorin e bujqësisë, sidomos në sera dhe stalla, që kapin vlerën prej 622 mijë eurosh. Dëmet në objektet e arsimit janë 162 mijë euro, ku përfshihen shkollat fillore dhe të mesme të Komunës së Istogut. Në ndërtesa publike komunale janë 115 000 euro dëme, në infrastrukturë rrugore dëmet janë 40 000 euro si në shenja të emërtimit të rrugëve, shenja të komunikacionit, sistemi i kamerave dhe ndriçimit publik. Në objektet shëndetësore dëmet janë 14 000 euro, ku përfshihen QKMF-Istog, QMF-Banjë, QMF-Vrellë, AMF-Kaliqan. Ndërsa deri më tani në komunë janë lajmëruar mbi 800 persona për dëme në objekteve private, ku konsiderohen mbi gjysmë milioni euro dëme të shkaktuara. Duke qenë se buxheti i Komunës së Istogut është i ulët dhe mundësitë buxhetore janë minimale për kompensimin e këtyre dëmeve, Komuna e Istogut pret mbështetjen e Qeverisë së Kosovës për kompensimin e dëmeve", ka njoftuar kjo komunë.

## Ura e Veternikut lëshohet për qarkullim në muajin mars

PRISHTINË 11 SHKURT (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Lumir Abdixhiku, bashkë me zyrtarët dhe inxhinierët përgjegjës të projektit, të martën (11.02.2020) vizituan punimet që po zhvillohen në zgjerimin e rrugës nacionale N2, segmenti hyrja në qytetin e Prishtinës nga ana e Veternikut, bashkë me urën që i lidhë rrugët nacionale N2 dhe N25.2, me kyçjen e autostradës R7 "Ibrahim Rugova". Ministri Abdixhiku ka theksuar se kanë arritur ta përshpejtojnë planin dinamik të punimeve në këtë projekt, duke u bazuar në kushtet atmosferike. Kësisoj, akset kryesore të këtij projekti pritet të lëshohen në qarkullim në fillim të marsit, përderisa në të tjera detaje në të cilat nuk mund të punohet gjatë dimrit, do të të punohet edhe përgjatë marsit. Kosto e projektit është rreth 2.5 milionë euro dhe punimet kanë filluar në korrik të vitit 2019.



# Zyra Rajonale e Punësimit ofron përkrahje për grupet e margjinalizuara në Mitrovicë

MITROVICË, 11 SHKURT (ER) - Drejtori i Zyrës Rajonale të Punësimit, Besmir Salihu, ka pritur në një takim përfaqësuesit nga grupet e margjinalizuara në Mitrovicë, me ç'rast është diskutuar për nevojën e shtimit të bashkëpunimit dhe komunikimit në mes të dy palëve. Qëllimi i këtij takimi ishte përkrahja dhe përfshirja e këtyre kategorive në kuadër të programeve të cilat i zbaton Zyra e Punësimit në Mitrovicë. Me këtë rast, drejtori Salihu ka theksuar se këto takime me organizata janë të një rëndësie të veçantë, pasi që përmes tyre do të nxjerrim rekomandime të cilat mund të adresohen dhe të lehtësohet qasja për integrim në tregun e punës për këto kategori, respektivisht në Komunën e Mitrovicës. Po në këtë takim përfaqësuesit nga organizatat kanë prezantuar pikëpamjet e tyre dhe kërkesat që kanë për përkrahje në punësim dhe kanë falënderuar iniciativën e Zyrës së Punësimit për bashkëpunimin e treguar.



# Gjilani jep bursat për 12 studentët e ekselencës



GJILAN, 11 SHKURT (ER) - Komuna e Gjilanit ka ndarë bursa për 12 studentët e ekselencës në kuadër të Fondit të Ekselencës "Pak nga ne, shumë për ata III", të krijuar me iniciativë të kryetarit të kësaj komune, Lutfi Haziri. Këto bursa janë bërë publike të martën nga Haziri dhe kryetari i Klubit Rotarian "Gjilani", Shpëtim Miftari, pas takimit me tre nga 12 studentët e ekselencës, Rilind Ramadani, (Gerogia State University, ShBA), Valdrin Jonuzi (University of San Francisko, ShBA) dhe Dafina Abdyli, studente e ardhshme në kiminë inxhinierike. "Këta djem e vajza e kanë bërë punën vetë, sepse me dije, përkushtim dhe angazhim kanë arritur t'i bindin universitetet se kanë kapacitete për shkollim universitar, në nivelet e shkollave më të mira. Edhe në sistemin parauniversitar ne mbështesim djem dhe vajza të cilët kanë treguar aftësi të veçanta në mësimnxënie, duke i përgatitur si kuadro të reja", ka deklaruar Haziri në konferencën për gazetarë.

Haziri i ka siguruar ata se kjo mbështetje do të jetë deri në përfundim të studimeve, duke shtuar se ky është një prej programeve që Komuna e Gjilanit e ka filluar bashkë me klubin rotarian "Gjilani". Ndërsa kryetari i Klubit të Rotarianëve "Gjilani", Shpëtim Miftari, ka thënë se ata në vazhdimësi përpiqen ta ndihmojnë komunitetin me të gjitha kapacitetet. "Në këtë kontekst, ne me kënaqësi i jemi bashkuar komunës për mbledhjen e fondit për bursat e ekselencës. Do ta vazhdojmë bashkëpunimin me kryetarin Haziri edhe për mbledhjen e fondeve të tjera", ka thënë Miftari.

# Haskuka dhe kryeshefi i KEDS-it nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

PRIZREN, 11 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me kryeshefin ekzekutiv të KEDS-it, Alper Erba , kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e disa projekteve të rëndësishme për komunën e Prizrenit. Projekti më i rëndësishëm është ai i shtrimit të rrjetit nëntokësor të kabllove të rrymës elektrike në Qendrën Historike të Qytetit, përkatësisht në Shatërvan. Punimet e këtij projekti do të fillojnë sivjet, ndërsa rehabilitimi do të bëhet nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Ndërsa nga ky bashkëpunim do të realizohen edhe projektet për shtrimin e rrjetit elektrik në Cvilen dhe në Kabash deri te kalaja, si dy lokacione me potencial për të qenë destinacione të rëndësishme turistike.





# Lladrovci i jep mirënjohje drejtorit të deritanishëm të kompanisë 'Pastrimi'

DRENAS, 11 SHKURT (ER) - Me rastin e pensionimit, kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka pritur në takim drejtorin e deritanishëm të ndërmarrjes regjionale "Pastrimi", Muhamer Qela, të cilin e ka falënderuar për bashkëpunimin e treguar me këtë komunë për realizimin e projektit në menaxhimin e mbeturinave. Kryetari Lladrovci në shenjë bashkëpunimi i ka dhënë edhe mirënjohje drejtorit të deritanishëm të kësaj kompanie, Muhamer Qela dhe i ka uruar shëndet në pensionim.

# Komuna e Prishtinës mban sesion informues për ndarjen e granteve për biznese

PRISHTINË, 11 SHKURT (ER) - Komuna e Prishtinës, në bashkëpunim me Organizatën Help, bashkëfinancon projektin "Mbështetje stabilitetit socio-ekonomik në Ballkanin Perëndimor". Qëllimi i projektit është ngritja e kapaciteteve të grupeve të cenueshme socio-ekonomike dhe gjithëpërfshirja në shoqëri. Përmes projektit ndahen grantet për mikrobizneset dhe trajnimet profesionale e për biznes, duke ndikuar në stabilitetin socio-ekonomik për këto kategori shoqërore. Në kuadër të këtij projekti, sot (e mërkurë) mbahet sesioni informues për aplikim për grante. Ky sesion informues do të mbahet në orën 10:00 në Sallën e Kuvendit Komunal të Prishtinës.



# ‘Bleibende Spuren’ prezantohet për herë të shtatë në Zvicër

Libri me rrëfime nga jeta e autores Basrie Murati-Sakiri, “Bleibende Spuren”, është duke tërhequr vëmendjen e lexuesve të shumtë në Zvicër. Ai është botuar më 30 prill 2019 nga njëra prej shtëpive më të njohura botuese, “Rotpunktverlag”.
Ky libër përbëhet nga dy pjesë: pjesa e parë në fokusin kryesor e ka kohën shtator 1988-maj 1989, ndërsa pjesa e dytë përfshinë një periudhë më të gjatë kohore, duke filluar nga qershori i 1989-s deri më 2019.
Në pjesën e parë autorja është gjimnaziste e vitit të tretë. Ajo është aktive politikisht si në organizimin e demonstratave, po ashtu edhe pjesëmarrëse në to. Shkaku i ndjekjes për t’u arrestuar detyrohet të qëndrojë fshehur për 3 muaj me radhë dhe pastaj të largohet nga Kosova. Ndërsa në pjesën e dytë, nga qershori i vitit 1989, autoren e ndeshim në Zvicër. Në rrethana krejtësisht të reja, larg familjes dhe atdheut, ajo e vazhdon e vetmuar luftën për mbijetesë të dinjitetshme dhe integrim shembullor në shoqërinë zvicerane. Që të gjitha i arrin me sukses.
Jo për përmbajtjen, por pikërisht për prezantimet e shumta që ka pasur deri më tani libri, për mënyrën e organizimit të tyre, për interesimin e publikut si dhe për reagimet e tij, për “Epokën e re” biseduam me autoren Basrie Murati-Sakiri.



**“Epoka e re”:** *Prezantimi që do të mbahet të enjten, më 13 shkurt, në Bern, është prezantimi i shtatë i radhës i librit tuaj “Bleibende Spuren”. Çfarë mendoni që mund të jetë e veçanta e këtij prezantimi?*
**Basrie Sakiri-Murati:** Çdo prezantim dallon nga tjetri dhe është i veçantë në vete, edhe pse në fokus është gjithherë libri “Bleibende Spuren”. Kësaj radhe jam e ftuar në kuadër të një trilogjie femrash nga anë të ndryshme të botës, si Afrika, Armenia dhe unë, si shqiptare, nga Kosova. Secila nga ne do ta prezantoj librin e vet, me motive të caktuara, sigurisht krejt të ndryshme. Unë do ta prezantoj librin tim dhe nëpërmes tij edhe një pjesë të rëndësishme të historisë sonë. Me ftesën e saj, Qendra Kulturore e lagjes së Ittigenit, një ndër komunat më të mëdha të kryeqytetit të Zvicrës, Bernit, ka treguar interesim për librin tim, me këtë edhe ndaj atdheut tim: historisë, kulturës dhe traditës së tij.



**“Epoka e re”:** *Është në interesin e lexuesve në Kosovë të kenë një ide më të qartë përkitazi me prezantimet e librave që organizohen nga shoqëria zvicerane. A na e përshkruani ju lutem rrjedhën e një prezantimi, duke përfshirë edhe procedurat përgatitore?*
**Basrie Sakiri-Murati:** Në thelbin e prezantimit të librit qëndron leximi paraprak i tij. Nga këtu fillon gjithçka. Në mesin e shumë lexuesve, ndonjëri nga ata qëllon të jetë punonjës në ndonjë institucion, shoqatë apo bibliotekë, dhe pasi që ata të jenë ndarë të kënaqur me përmbajtjen e librit, shfaqin idenë, marrin kontakt me mua dhe e bëjnë ftesën për ta prezantuar atë në institucionin e tyre. Ftesën, në rastet e zakonshme, e bëjnë nëpërmes shtëpisë botuese, “Rotpunktverlag”, duke u nisur nga fakti se ajo ka koordinatat e mia. Mirëpo, kam pasur raste kur jam ftuar drejtpërsëdrejti nëpërmes shkresës postale. Tërë organizimi bëhet nga personi përgjegjës i institucionit përkatës, kuptohet në bashkëpunim të ngushtë me mua. Çdo informatë rreth rrjedhjes së prezantimit e këmbejmë nëpërmes postës elektronike, e-mailit. Prezantimi bëhet në lokale të ndryshme, mirëpo zakonisht preferohen ambiente që janë të dedikuara enkas për aktivitete kulturore. Pjesëmarrja aktive e publikut përmes parashtrimit të pyetjeve, emocionet e shprehura prej tij si dhe vlerësimi që i bëhet librit, guximit dhe qëndresës time, si veprimtare politike, më bëjnë të kuptoj se libri im është i dëshiruar. Është një ndjenjë tejet gjallëruese kur vërej se sa lart i vlerësojnë përpjekjet e atëhershme të rinisë së Kosovës për liri, çlirim nga Serbia, por edhe angazhimet e mia të kohës për të drejtat dhe emancipimin e femrës. Janë këta faktorë të cilët jo vetëm që më motivojnë, por edhe më ringjallin ndjenja të papërshkruara për atë periudhë, sa sakrifikuese e të dhimbshme, aq edhe të dashur e të lavdishme.

**“Epoka e re”:** *Nuk ka recensione nga recensentë të ndryshëm që paraqiten në prezantime të tilla, siç praktikohet kryesisht në Kosovë?*
**Basrie Sakiri-Murati:** Vetë mënyra e ftesës tregon se fjala është për prezantimin e librit dhe bisedën që do të bëhet me autoren. Kështu që libri e autori janë në qendër të vëmendjes. Prezantimi udhëhiqet nga një moderator/e, ndërsa unë prezantoj librin tim, duke filluar me sqarimin e motivimit të shkrimit si dhe shpjegimit të arsyes pse mora hapin ta publikoj një libër të tillë, siç është “Bleibende Spuren” në këtë rast. Herë pas here lexoj ndonjë fragment të përzgjedhur nga libri, që e bënë atmosferën të jetë më artistike. Pastaj në pjesën e fundit vazhdojmë me bashkëbisedim, me ç’rast publiku me kureshtje të madhe parashtron pyetje rreth ngjarjeve dhe periudhës së përshkruar në libër. Biseda zhvillohet pothuaj në një atmosferë familjare, duke pasur parasysh faktin se në mesin e publikut ka gjithnjë nga ata të cilët e kanë lexuar librin. Në fund fare, pjesëmarrësit e blejnë librin, kërkojnë nënshkrimin dhe shfaqin dëshirën për një fotografi të përbashkët me autoren në shenjë kujtimi. Recesionet klasike, siç praktikohen në Kosovë, nuk preferohen në shoqërinë zvicerane. Kam mendimin se pas një praktike të tillë qëndron interesimi i tyre për ta dëgjuar zërin e autorit dhe për t’u njohur me idetë dhe pikëpamjet e tij.




**“Epoka e re”:** *Cili ka qenë prezantimi i fundit dhe çfarë ju ka bërë përshtypje apo pëlqyer më së shumti?*
**Basrie Sakiri-Murati:** Prezantimin e fundit e kam pasur në bibliotekën e Arkivit Social të Zvicrës, në Cyrih. Ishte bashkëpunimi tejet profesional i moderatores, njëherësh drejtoreshës së bibliotekës, zonjës Susanne Brügger, dhe vëmendja e publikut kureshtar, që në shumë çaste më bënë ta ndiej veten sikur isha duke i jetuar ato ngjarje, fragmente nga të cilat lexoja. Ata me modestinë e tyre tregonin vëmendje dhe një kujdes admirues jo vetëm ndaj meje dhe ngjarjeve të përshkruara në libër, por edhe ndaj historisë sonë të afërt.
M’u bë zemra mal kur nga mesi i publikut u lajmëruan edhe të rinj shqiptarë, shumica e të cilëve ishin të lindur e rritur në Zvicër, por me pjesëmarrjen e tyre aktive tregonin interesim të madh për ngjarjet e asaj kohe në Kosovë.

**“Epoka e re”:** *Cilat janë prezantimet e radhës që keni planifikuar t’i keni në të ardhmen?*
**Basrie Sakiri-Murati:** Prezantimi tjetër, i teti me radhë, do të mbahet më datën 17 shkurt 2020. Ai është organizuar nga Shkolla Rudolf Steiner, adresa e së cilës është: Ittingenstrass1 31, 3063 Ittingen. Sipas interesimit të shkollës, librin do ta prezantoj për nxënësit e klasës së dhjetë. Nëse në ndërkohë nuk do të ketë ndonjë organizim tjetër, prezantimi i nëntë është planifikuar për datën 5 qershor 2020. Kësaj radhe librin tim do ta prezantoj për publikun e St. Galles në bibliotekën kryesore të këtij qyteti, Bibliothek Hauptpost. Adresa e saj është: Gutenbergstrasse 2, 9001 St. Gallen.

**“Epoka e re”:** *Përveç në prezantime, ku mund ta gjejnë të interesuarit tjetërkund librin tuaj?*
**Basrie Sakiri-Murati:** Librin tim të interesuarit mund ta gjejnë te Shtëpia Botuese “Rotpunktverlag”, në të gjitha libraritë e Zvicrës, Gjermanisë, Austrisë si dhe në bibliotekat e shumta të këtyre shteteve.

**(Faton DËRMAKU)**

# Oh, Nexhë!

Elife PODVORICA

… dëgjova prapa shpinës sime një ofshamë të thellë që doli nga kraharori i një mikes së Nexhës, miqësia e së cilës me të ishte e thellë si vetë ofshama e saj në këtë çast, ku e rënduar nga një buqetë e madhe lulesh të freskëta po i jepte lamtumirën e fundit mikes së saj këtu në hollin e Teatrit Kombëtar në Prishtinë.

Kush ishte kjo përpos Shpresa Berishës, e cila Nexhën e kishte pasur jo vetëm mike prej vitesh të tëra, por edhe kolege të skenës për shumë vite nëpër skenat e ndryshme shqiptare, ballkanike e evropiane. I kishte bashkuar kënga. Kënga artistike me vlerat më të larta autoktone shqiptare.

…"Mbaj në mendje e në shpirt një moment i cili Nexhmijen e ruan me dashurinë më të ngrohtë në zemrën time dhe kur dua të udhëtoj nëpër vitet e rinisë sime, e kujtoj me shumë mall e dashuri. Ishin ato vite të arta të karrierës sime, në të cilat pata fatin që Nexhën ta takoja në skenë" - ktheu shikimin Shpresa nga unë dhe vazhdoi rrëfimin sikur të ishte një bisedë e lënë diku përgjysmë ndër vite.

"Nexha nuk bënte komplimente, ishte e rreptë në kritikat e saj si këngëtare. Por, unë në një moment kur po dilja nga skena dukej që ia kisha rrëmbyer zemrën me interpretimin tim dhe ende pa u shkëputur mirë nga skena dhe nga duartrokitjet e pandalshme në sallë, ajo m'i kapi të dy duart dhe më tha": - "Zemër, kështu duhet të këndohet". Isha shumë e re, vetëm 17 vjeçe dhe të merrja lëvdata të tilla nga ylli i skenës, ishte tejet emocionuese për mua".

Ishte viti 1979 dhe kjo ngjarje ishte në Tiranë, me ç'rast unë këndova këngën e "Lidhjes së Prizrenit" dhe publiku në sallë me duartrokitjet më ktheu disa herë në skenë.

Por, gëzimin më të madh e përjetova nga ato fjalë të sinqerta të Nexhës që m'i tha dhe i ruaj si relikte të arta në kujtesën time. Ishte shumë motivuese për mua që ajo të ndante një mendim të tillë profesional. Sepse, Nexha ishte një këngëtare me një disiplinë të lartë prej artisteje të kompletuar në çdo segment që arti i këndimit e kërkonte.

"Baresha", me të cilën u identifikua gjithë karriera e saj, jo vetëm që është një këngë popullore. Ajo është një arie operistike në të cilën mplekset një thesar i tërë i vlerave artistike dhe motiveve të pasura shqiptare. Kjo këngë vuri në pah gjithë bukurinë e zërit të saj magjik, i cili ishte i begatshëm me ata tinguj profondo të një alti të thellë duke u ngjitur lart si një gurgullim krojesh të pastra në majat e tij më të larta e që i jepte sharmin e një sopranoje brilante.





Rexho Mulliqi e pat atë aftësi kompozicionale që të hynte në tërë atë thesar vokali që Nexhmija e posedonte. Mahniteshim të gjithë ne të tjerët me prezantimin e saj skenik. Ndihem krenare për këtë gjë shumë sa herë i kujtoj edhe ato momente që unë e kisha fatin t'i ndaja edhe në prapaskenë kur Nexha përgatitej të dilte para publikut dhe t'ia thoshte këngës. Kishte çdoherë tremë dhe emocione të thella para daljes në skenë. Këndimi ynë atëherë ishte vetëm "live" dhe kjo kërkonte një përkushtim të jashtëzakonshëm. Sepse, kudo që shkonim, ne përfaqësonim një komb të tërë.

Por, Nexha shndriste çdoherë.



Sikur kishte tërë shkëlqimin e diellit të fshatit të saj Pagarushë. Sikur kishte me vete në zërin e saj gjithë cicërimën e zogjve dhe gurgullimën e krojeve të fshatit të saj.

Më beso - m'u kthye Shpresa sikur të ishte kujtuar që ka një bashkëbiseduese para, se ashtu dukej edhe atë ditë kur me bashkëshortin tim e çuam deri në fshatin e saj të lindjes, edhe pse Nexha nuk ishte më e re si dikur me atë bukuri magjepsëse. Mbi shpatullat e saj rëndonin vitet e pleqërisë. Por, pavarësisht tyre, atë ditë ndihej shumë e lumtur. Në fytyrën e saj sikur dolën në pah gjithë ato tipare karakteristike të cilat i jepnin një sharmë unik figurës së saj. Dhe me atë ndjesi malli e dashurie që pas një kohe të gjatë po i kthehej vendlindjes së saj, u kthye nga ne të dytë dhe na tha: "O të dashurit e mi, faleminderit që më sollët sot këtu! Kështu më sillni edhe ditën kur unë do ta jap frymën e fundit". I tha këto fjalë duke na shikuar në drita të syrit dhe nëpër faqet e saj të vyshkura nga hija e pleqërisë, u rrokullisën dy pika lotësh.

Po më thoshte Shpresa sot, një ditë pas varrimit të Nexhës në fshatin Pagarushë, në kortezhin e së cilës kishte qenë edhe ajo.






Po, Nexhmije Pagarusha "Bylbyli i Kosovës" dje u përcoll në botën e amshimit me nderimet më të larta shtetërore. Në lamtumirën e saj të fundit qenë të pranishëm artistë e intelektualë nga të gjitha trojet shqiptare. Kryeministri i ri i Kosovës, z. Albin Kurti, në fjalimin e tij në mënyrë shkencore kishte përmbledhur të gjitha periudhat e jetës së saj si artiste duke filluar edhe në atë periudhë kur Nexha në opusin e vet të begatshëm artistik kishte të incizuara arie antike nga kompozitorë të renesansës siç ishte G. Pergolesi, A. Scarlatti e të tjerë. Është ky një opus këngësh klasike që pakkush e di në Kosovë. Vetëm ata të cilët kanë pasur rastin të rrinë me Nexhmijen, ose ata të cilët kanë rrëmuar nëpër vitet e saj të kultivimit të saj si artiste. Këtë ndjesi na e dha sot kryeministri Kurti, i cili na rrëmbeu të gjithëve në sallë me atë elokuencë fjalësh rreth figurës së saj.

Dhe Nexha shkoi, ashtu siç erdhi në këtë botë, për t'i lënë gjurmët e saj të përjetshme në sfondin më të ndritshëm shqiptar.

Qoftë i përjetshëm kujtimi për ty e dashur! - tha Shpresa në momentin kur Nexha u përcoll nga duartrokitjet lamtumirëse të miqve e dashamirëve të saj të shumtë e u nis drejt rrugës së amshimit.

A thua si do të ishte Kosova dhe arti shqiptar pa ekzistencën e Nexhmije Pagarushës? Është pyetje që aq shumë herë ia kam bërë vetes në çaste të caktuara.

Qoftë i përjetshëm kujtimi për ty, znj. Nexhmije!

**Republika e Kosovës - Republic of Kosovo**
**Trepça - Shoqëri Aksionare**
**Trepça - Deoničarsko Društvo**
**Trepça - Joint Stock Company**

TREPÇA

Adresa: Parku industrial Mitrovicë, Tel. 028/538 050, 531 135, Fax: 028/539 202 web: www.trepcacorporation.org
Address: Mitrovica Industrial Park. Tel. 028/538 050, 531 135, Fax: 028/539 202 web: www.trepcacorporation.com

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës, nenit 22 paragrafi 4 të Statutit të Trepçës, Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik, dhe nevojave të paraqitura për plotësimin e disa vendeve të lira të punës, Trepça Sh.A me dt. 12.02.2020 shpall:

**K O N K U R S**

**Zyrtar i Lartë Ligjor (1 pozitë)**

Kohëzgjatja e Emerimit: E përhershme

a) Detyrat dhe përgjegjësitë
- Me autorizimin e Sekretarit korporativ, përfaqëson dhe mbron interesat e Ndërmarrjes Trepça Sh. A. para organeve gjyqësore dhe institucioneve tjera përkatëse;
- Hartimin i vendimeve, rekomandimeve, këshillave ligjore dhe akteve të tjera që i nxjerrë Menaxhmenti i Trepça Sh.A.
- Përgatitjen dhe dhënien e këshillave juridike e procedurale, për parashtresat me karakter ligjor që i adresohen Ndërmarrjes Trepça Sh. A.;
- Përgatit memorandume, marrëveshje dhe dokumente tjera ligjore me të cilat sigurohet administrimi efektiv dhe efikas i Trepça Sh. A.;
- Bashkëpunon ngushtë me departamentet, zyrat dhe Njësit Biznesore të Trepça Sh. A., për çështje ligjore në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi;
- Me autorizimin e Sekretarit Korporativ, merr pjesë në komisione dhe grupe përkatëse punuese brenda dhe jashtë Ndërmarrjes Trepça Sh. A.;
- Përgatitë raporte dhe mbanë evidenca lidhur me kryerjen e punëve brenda përgjegjësive të Zyrës ligjore;
- Kryen dhe detyra tjera shtese me urdhër të Sekretarit.

b) Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:
- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën e legjislacionit dhe hartimin e akteve ligjore;
- Te kenë të përfunduar provimin e jurisprudencës, e obliguar;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës dhe udhëheqje të ekipit;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve të këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);
- Njohja e gjuhës angleze e preferueshme;
- Diplomë universitare, minimum 1 vite përvojë pune juridike.

INFORMATË E PËRGJITHSHME PËR KANDIDATËT LIDHUR ME PROCEDURAT E KONKURIMIT

Trepça Sh.A, ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjitha komunitetet në Kosovë.

Dokumentet përcjellëse si vijon:

- Dëshmitë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i),
- Letërnjoftimin kopje,
- Certifikatën nga gjykata që nuk është i dënuar.
- Dëshminë e përvojës së punës.

Formulari i aplikacionit duhet të merret në Divizionin e burimeve njerëzore, ndërtesa e Menaxhmentit të Trepça Sh.A, Parku Industrial Mitrovicë, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri 16:00, ndërsa dorëzimi i formularit së bashku me dokumentacionin e kërkuar duhet të paraqitet në email adresën contact@trepcacorporation.com.

Dokumentacioni i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm.

Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen për testim dhe intervistim.

Afati i konkurrimit është 15 ditë nga dita e shpalljes në gazetë.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen.

Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 028/538-050.



# Modeluesja spanjolle, tifoze e Real Madridit

Marta Lopez Alamo është një modeluese në ngritje në Spanjë, teksa me fotot e saj mjaft "të nxehta" që poston rregullisht, ka arritur të grumbullojë më tepër se 125 mijë ndjekës në "Instagram" brenda një kohe shumë të shkurtër. Bukuroshja 22-vjeçare ka ndarë me fansat edhe një pasion tjetër të saj, atë për futbollin, ndërsa ka zbuluar se është një tifoze e "zjarrtë" e Real Madridit.

# Jennifer Lopezi, "mbretëresha" e festës së Oscar-it



Pavarësisht se fansat e Jennifer Lopezit "u çmendën" për faktin se ylli i Hollywoodit nuk është nominuar për rolin në filmin "Hustlers", kjo duket se nuk e ka shqetësuar shumë 50-vjeçaren. Madje aktorja ka shfaqur entuziazëm edhe për festën e pas ceremonisë së çmimeve Oscar. JLO ishte bërë si një mbretëreshë e vërtetë e veshur me një fustan që i ekspozonte këmbën e dekoltenë. Fotot tepër mahnitëse e seksi, Lopezi i ka postuar në "Instagramin".

# Amber Rose bën emrat e djemve tatuazh në fytyrë

Amber Rose ka vendosur të ketë një kujtim të përhershëm të fëmijëve të saj në fytyrë. Modeluesja 36-vjeçare është parë me një tatuazh goxha të madh në ballë ku shkruan "Bash" dhe "Slash", emrat e dy fëmijëve të saj. Rose është fotografuar me tatuazhin e ri kur po bënte blerje, derisa ende nuk e ka zbuluar atë në rrjete sociale.



E jashtëzakonshme

## Nëntëvjeçarja që shtatë vjet realizon tatuazhe




Maya Lu është vetëm nëntë vjeçe, por ajo tashmë ka shtatë vjet përvojë në realizmin e tatuazheve. Vajza nga Tengeni i Gjermanisë së Jugut kishte filluar të mësojë si të pikturojë, kur ishte vetëm dy vjeç dhe tani ajo e ka vendin e saj në studion e tatuazheve. Maya është rritur me prindër që kanë bërë shumë tatuazhe në trupin e tyre dhe është njëkohësisht edhe vajza e një artisti shumë të njohur të tatuazheve. Prindërit ishin klientët e saj të parë dhe ata e kanë ndihmuar vogëlushen përgjatë viteve t'i zhvillojë aftësitë e saj. Sot nëntëvjeçarja mund të bëjë tatuazh pa ndihmën e prindërve të saj. Mami i Maya është shprehur se është e mahnitshme të shohësh se si vajza e saj realizon tatuazhet.

FOTO E DITES




Kisha e Unifikimit në Qendrën Botërore të Paqes në Korenë e Jugut ka organizuar një ceremoni të madhe martesore. /AFP/

E rrallë

## 107-vjeçari që ende vozitë 'Mercedesin' me të fejuarën 100-vjeçare




Joe Newman, 107 vjeç, është banori më i vjetër i ndërtesës ku jeton ai në Sarasota të Floridës. "Natyrisht që kam dhimbje", ka thënë Newmani për "Today" të NBC-së. Ai ka thënë se në këtë moshë vallëzon dhe vozitë veturën. Ky i moshuar është bërë i famshëm në këtë vend me veturën e tij "Mercedes 320" me ngjyrë qershie, të cilin e ka blerë nga mjeku i tij kur ishte 103 vjeç. "Kur e pashë për herë të parë zemra ime rrahu më shpejt", ka thënë Newmani. Për argëtim, Newmani kënaqet duke u vozitur nëpër qytet me të fejuarën e tij, Anita Sampson, e cila muajin e ardhshëm do të bëhet 100 vjeçe.

## BARSOLETA E DITËS



**Pacienti: Doktor, jam shumë i shqetësuar!**
**Doktori: Qetësohu dhe më thuaj çfarë ke?**
**Pacienti: Një kinez ma ka dërguar kërkesën në "Facebook" për shoqëri. Çfarë të bëj?**
**Doktori: Mua mos më shkruaj më, ndërsa kinezit bëja bllok, se shkuam poshtë!**

KINO ABC PRISHTINE

**Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC**

Në ora 18:00

### Spies in Disguise 3D




I Animuar/Aksion/Aventurë; 1 orë 42 min

**Rolet:** Will Smith, Tom Holland, Ben Mendelsohn, Karen Gillan, Rashida Jones, DJ Khaled, Masi Oka

**Regjia:** Troy Quane, Nick Bruno




Në ora 18:00

### Jumanji; The Next Level 3D

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 03 min
**Rolet:** Dwayne Johnson, Jack Black, Kevin Hart, Karen Gillan, Nick Jonas, Awkwafina, Ser'Darius Blain, Madison Iseman, Morgan Turner, Alex Wolff, Danny Glover, Danny DeVito, etj.
**Regjia:** Jake Kasdan

Çdo natë në ora 20:00

### STAR WARS; THE RISE OF SKYWALKER 3D




Aksion/Aventurë/Fantazi; 2 orë 21 min
**Rolet:** Daisy Ridley, Adam Driver, Mark Hamill, John Boyega, Oscar Isaac, etj
**Regjia:** J.J. Abrams




Çdo natë në ora 22:30

### THE GRUDGE

Horror/Mister; 1 orë 34 min

**Rolet:** Sarah Michelle Gellar, Jason Behr, Kadee Strickland, Clea Duvall and Bill Pullman

**Regjia:** Takashi Shimizu

**Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.**



**DASHI**
Çdo gjë që bëni do të jetë e suksesshme dhe dita juaj mund të thuhet se do të jetë një "kryevepër". Në punë është e mundur të korrigjohen gabimet dhe të gjeni zgjidhje për problemet.



**DEMI**
Do të propozoni një projekt me qartësi dhe kohë, duke u dhënë formë ideve që vijnë rreth kokës tuaj. Nëse e shihni veten në vështirësi, dëgjoni mendimin e një miku autoritar.



**BINJAKËT**
Duke pasur një hënë armiqësore dhe një humor të lëkundur sot, zgjidhni një pushim gjatë ditës, si fizike ashtu edhe mendore. Zgjidhni të shikoni një film të mirë ose të dëgjoni muzikë të mirë!



**GAFORRJA**
Pranoni ofertën e udhëtimit dhe argëtimit të një shoqërie të gjallë dhe të ndritshëm. Ditë e shkëlqyeshme nga një këndvështrim profesional për shumicën prej jush.



**LUANI**
Me një gjakftohtësi të madhe do të arrini të menaxhoni një situatë mjaft delikate. Në dashuri, kur doni vetë, ju mund të jeni shumë simpatik.



**VIRGJËRESHA**
Marrëveshje të shkëlqyera. Dashuria do të jetë energji e pastër për ju; do të jetë burimi juaj i optimizmit, i guximit, i gjithçkaje që e bën jetën tuaj të bukur.



**PESHORJA**
Merrni kohën tuaj dhe mos u tregoni të nxituar sepse mund të mashtroheni. Dashuria ju rezervon gëzim dhe qetësi ndryshe nga shëndeti. Mos e lini pas dore trupin tuaj, veçanërisht nëse ju jep sinjale alarmi.



**AKREPI**
Aftësia juaj për të planifikuar është e frikshme dhe dikush do t'ju bëjë thirrje për ndihmë. Do të merrni një vizitë interesante nga disa miq që mund t'ju inkurajojnë me idetë e tyre.



**SHIGJETARI**
Në punë qëndroni larg atyre që ushqejnë polemikë dhe konflikte dhe vazhdoni rrugën tuaj. Ju jo gjithmonë do të jeni në gjendje të ndërmjetësoni.



**BRICJAPI**
Sot, nëse mundeni, planifikoni diçka për ditët në vazhdim që ju duket interesante dhe e rëndësishme. Suksesi që do të arrini në shoqëri do t'ju japë një nxitje shumë të fortë.



**UJORI**
Një çështje familjare kërkon një vendosmëri shumë të madhe dhe disponueshmëri. Një marrëveshje e rinovuar me partnerin tuaj do t'ju sjellë gëzim dhe do t'ju mbushë me mendime serioze.



**PESHQIT**
Ju mund të ndiheni të zhgënjyer nga sjellja e një personi shumë të afërt. Do të ndiheni i tradhtuar, por nuk është ashtu siç duket.




Sport




# Feronikeli kërkon kualifikimin në gjysmëfinale

**Feronikeli synon që të jetë skuadra e katërt që siguron gjysmëfinalen e Kupës, kurse synimet e kësaj skuadre janë ta mbrojë këtë trofe dhe të marrë pjesë në garat ndërkombëtare. Në anën tjetër, skuadra e Lirisë, që synim primar e ka rikthimin në Superligë, ka paralajmëruar se në këtë ndeshje nuk do të dorëzohet dhe do të kërkojë të shkaktojë befasi**



EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 11 SHKURT - Skuadra e Feronikelit u është rikthyer stërvitjeve në fushën sintetike në Drenas të mërkurën, pas fazës përgatitore që e kaloi në Antalya të Turqisë. Kjo ishte përgatitja e fundit për ndeshjen çerekfinale të DigitAlb Kupës së Kosovës në futboll, të cilën fituesi në fuqi i Kupës, Feronikeli, e zhvillon në Prizren ndaj Lirisë.

Futbollisti Albert Dabiqaj ka thënë të martën për "Epokën e re" se Liria ka një skuadër të mirë, por në gjysmëfinale do të kualifikohet skuadra nga Drenasi për faktin se e ka rrugën më të lehtë për të dalë në garat evropiane. "Synimi ynë është të zhvillojmë një lojë të mirë dhe të kualifikohem në gjysmëfinale, pasi kjo është rruga më e shkurtër për klubin tonë që të marrë pjesë në garat evropiane. Liria është një kundërshtare e fortë dhe ka një ekip të mirë, ani pse bënë gara në Ligën e Parë. Jemi përgatitur mirë për këtë ndeshje dhe e mira është se të gjithë lojtarët janë të gatshëm, prandaj do ta japim maksimumin për kualifikim", ka thënë Dabiqaj, i cili ka qenë i grumbulluar me Përfaqësuesen e Kosovës në ndeshjen miqësore kundër Suedisë.

Në anën tjetër, për ndeshjen që zhvillohet në stadiumin "Përparim Thaçi" nga ora 12:30 foli edhe trajneri Skënder Shengyli. Ky i fundit ka paralajmëruar se Liria do të luftojë edhe në këtë ndeshje me të gjitha forcat, ani pse synim kryesor e ka rikthimin në IPKO Superligë. "Pres një ndeshje të fortë. Do të jetë ballafaqim interesant ngaqë luajmë me kampionin në fuqi dhe fituesin e Kupës. Ne do të luftojmë si në çdo ndeshje, megjithëse synim mbetet lufta jonë në rrugën drejt kthimit në Superligë", ka thënë Shengyli.

Në gjysmëfinale të Kupës janë kualifikuar Ballkani, Drenica dhe Prishtina. Skuadra e Ismet Munishit, Ballkani, e mposhti Dukagjinin (0-2), kurse Drenica befasoi Gjilanin duke e mposhtur me rezultat 2-1. Prishtina e kishte më të lehtë përballjen me Vushtrrinë, prandaj shënoi fitore 4-1 në ndeshjen që u zhvillua në stadiumin "Fadil Vokrri". Fituesja e Kupës merr pjesë në Ligën e Evropës.

# Ekipi i boksit nis përgatitjet për kualifikim në 'Tokio 2020'



PRISHTINË, 11 SHKURT - Ekipi i boksit do ta nisë misionin për garën kualifikuese evropiane për Lojërat Olimpike "Tokio 2020", që prej 14-24 marsit mbahet në Londër të Anglisë. Gara organizohet nga Komiteti Olimpik Ndërkombëtar shkaku i problemeve me Federatën Ndërkombëtare të Boksit (AIBA). Edhe pjesëmarrja e boksierëve të Kosovës në këtë garë është duke u bërë përmes Komitetit Olimpik të Kosovës, ndërsa pjesëmarrës janë boksierë të kontinentit të Evropës.

Në këtë garë kualifikimin në "Tokio 2020" e kërkojnë: Donjeta Sadiku (-60 kg), Shpëtim Bajoku (-63 kg), Patriot Behrami (-69 kg) dhe Besart Pireva (-75 kg). Donjeta do të udhëtojë sot (e mërkurë) drejt Sofias së Bullgarisë, ku për tri ditë do të përgatitet bashkë me trajnerin e saj, Besim Brahimi, ndërsa "stacioni" i radhës është kampi ndërkombëtar që mbahet në Trabzon të Turqisë, vend ky në të cilin do të përgatitet deri më 24 shkurt 2020. "Shpenzimet e përgatitjeve të saj do të mbulohen nga Komiteti Olimpik i Kosovës, bazuar në mbështetjen për sportistët elitarë, që janë bursistë të KOK-ut. Në këtë kamp do të udhëtojnë edhe Bajoku, Behrami dhe Pireva, të cilët prej të shtunës janë duke u përgatitur me përzgjedhësin Shefki Bogujevci në Vlorë të Shqipërisë", thuhet në njoftimin e KOK-ut.

## Gjeraj, kapiten i Lirisë

PRIZREN, 11 SHKURT - Kryesia e KF Liria, në bashkëpunim me shtabin teknik dhe futbollistët, vendosi unanimisht për kapitenin e ri. Kjo detyrë i është besuar futbollistit veteran Robert Gjeraj, kurse zëvendës të tij do të jenë Valon Bytyqi dhe Fatih Krahoda. "Falënderoj bashkëlojtarët, kryesinë dhe shtabin teknik për besimin e dhënë. Mendoj se secili nga ne të tretë ka mundur të jetë i pari në këtë detyrë. Na duhet shumë punë dhe angazhim që bashkërisht ta dërgojmë skuadrën drejt suksesit, e që objektiv ynë është Superliga", ka thënë Gjeraj për faqen zyrtare të klubit. Ai ka ftuar qysh nesër tifozët ta përkrahin skuadrën me Feronikelin, në ndeshjen e 1/4 të Digitalb Kupës së Kosovës.



## Vëllaznimi në finale të Kupës në Ligën e Parë

RAHOVEC, 11 SHKURT - Vëllaznimi ka mundur Istogun me rezultat 77:54 (24:8, 12:15, 23:11, 18:20) në gjysmëfinalen e Kupës së Ligës së Parë. Skuadra kuqezi e nisi ndeshjen për mrekulli, duke e fituar çerekun e parë 24:8. Perioda e dytë ishte më e barabartë, që përfundoi 12:15, kurse skuadrat shkuan në pushim me rezultat 36:23. Vëllaznimi u rikthye sërish në periudhën e tretë, duke e fituar 23:11, kurse rezultati në semafor pas 30 minutash tregonte shifrat 59:34. Në dhjetë minutat e fundit nuk kishte ndryshime (18:20) dhe Vëllaznimi triumfoi në fund 77:54. Te skuadra nga Gjakova u dalluan Rron Koshi me 22 pikë dhe Terric Philips me 21 pikë e 12 kërcime, kurse te Istogu më i dalluari ishte Diamant Shabani me 19 pikë e shtatë kërcime. Vëllaznimi në finalen që do të zhvillohet të enjten do të takohet me fituesin e përballjes AS Prishtina - Drita. Të gjitha ndeshjet e Kupës mbahen në palestrën "Mizahir Isma" në Rahovec.



# Rrahmani: E ëndërroja Evropianin e Botërorin me Shqipërinë, tani e pres me Kosovën

TIRANË, 11 SHKURT - Qendërmbrojtësi i Kosovës, Amir Rrahmani, ka thënë se ai e kishte pasur ëndërr të luante në Kampionatin Evropian ose në Kupën e Botës me Kombëtaren e Shqipërisë megjithatë, pasi që kjo ëndërr nuk iu realizua, ai tani pret ta arrijë atë me Kosovën. Rrahmani e ka mbajtur shiritin e kapitenit në disa ndeshje të rëndësishme të Kosovës në rrugëtimin në Grupin A kualifikues për Kampionatin Evropian. Përkundër që Kosova s'e arriti kualifikimin përmes grupit, Rrahmani mund ta ëndërrojë ende pjesëmarrjen në "Euro 2020". Kosova mund të kualifikohet në Evropian nëse e fiton ndeshjen gjysmëfinale kundër Maqedonisë së Veriut në kuadër të "play-off"-s, pastaj në finale kundër Gjeorgjisë ose Bjellorusisë. Të dyja këto ndeshje do të zhvillohen në muajin mars. Rrahmani e ka ëndërruar



që një kohë të gjatë kualifikimin, mirëpo ai fillimisht kishte shpresuar ta realizonte këtë ëndërr me Kombëtaren e Shqipërisë - për të cilën, para se t'i bashkohej Kosovës, i kishte bërë dy paraqitje, ndërsa për ekipin U21 kishte luajtur në 21 ndeshje. "Kombëtaret e vogla e kanë ëndërr Evropianin ose Botërorin dhe unë e ëndërroja me Shqipërinë, por nuk u realizua. Tani pres ta arrij me Kosovën", ka thënë Rrahmani në një intervistë për "Top Channel". Rrahmani, që tani luan në Serinë A për klubin italian Hellas Verona, ka pasur mjaft suksese në kampionat. Verona është kthyer në hirushen e kampionatit italian duke surprizuar të gjithë me rezultatet pozitive, madje të shtunën e lënë pas mundi Juventusin. "Të luash ndaj këtyre klubeve është gjithmonë e vështirë. Juventusi na mundi në ndeshjen e parë 2-1, kështu që është pak a shumë si hakmarrje e jona", ka shtuar ai. "Nëse një futbollist shqiptar luan mirë atëherë ai u hap derën edhe futbollistëve të tjerë. Edhe Lazio siç ua ka hapur derën futbollistëve shqiptarë, edhe këtu e kanë derën e hapur. Vendimi ishte i Veronës sepse e kishim një objektiv të përbashkët, që të qëndronim në Serinë A, por tani mendoj se ky objektiv është rritur. Edhe pse ende nuk është e sigurt mbijetesa, duke qenë se jemi në vendin e gjashtë, janë ndryshuar synimet tona", ka deklaruar Rrahmani.

# Toronto nuk ka të ndalur, Lakersat mposhtin Phoenixin

TORONTO, 12 SHKURT - Nuk ka të ndalur kampioni në fuqi i NBA-s, Toronto Raptors, që e mposhti në "Scotia Bank Arena", Minnesotta Timberwolves, me rezultatin 137-126 dhe regjistroi njëkohësisht suksesin e 15-të radhazi në kampionat, duke u konsoliduar në vendin e dytë në Konferencën e Lindjes.
Kanadezët e nisën mirë fraksionin e parë, por në pjesën e dytë miqtë u kundërpërgjigjën në mënyrën e duhur dhe rikthyen baraspeshën. Vendimtar në përcaktimin e fituesit ishte fraksioni i tretë, të cilin Raptorsi e fitoi me rezultat të thellë dhe më pas ruajti avantazhin. Pascal Siakam ishte sërish protagonist për Toronto Raptorsin pasi arriti të shënojë 34 pikë, t'i rikuperojë 6 topa dhe të japë 5 asistime,



ndërsa një ndeshje mjaft të mirë bëri edhe Kyle Lowry me 27 pikë, 7 rikuperime dhe 11 asistime. Nuk fal as Los Angeles Lakersi, që në "Staples Center" mposhti Phoenix Sunsin me rezultatin e thellë 125-100. Ky ishte suksesi i 40 sezonal për Lakersat, në 52 takime, rezultate këto që e kanë konsoliduar skuadrën nga Los Angelesi në krye të renditjes në Konferencën e Perëndimit, raporton "SS".
Vendasit patën tërë kohën kontrollin e lojës dhe treguan superioritet ndaj Sunsit, duke mos e diskutuar për asnjë moment triumfin, ndërsa protagonist ishte edhe Anthony Davies, që u shpall më i miri i ndeshjes. Dallas Mavericksi vijon të kalojë një periudhë me luhatje, teksa këtë herë është mposhtur në shtëpi me rezultatin e ngushtë 119-123 nga Utah Jazzi, duke pësuar humbjen e tretë në 5 ndeshjet e fundit të kampionatit. Utah bëri një gjysmë të parë të lojës në kufijtë e perfektes dhe arriti të krijojë një avantazh prej 17 pikësh, ndërsa reagimi i Dallasit në gjysmën tjetër ishte shumë i mirë, por i pamjaftueshëm për ta sjellë përmbysjen e rezultatit. Amerikani Tim Hardaway dhe letonezi Kristap Porzingis ishin sërish në një formë mjaft të mirë për Dallasin këtë mbrëmje, por edhe një herë pjesa tjetër e skuadrës stagnoi dhe nuk u ngrit në nivelin e dy yjeve të ekipit. Miami Heat i ka dhënë fund periudhës së errët prej tri humbjesh radhazi, pasi ia doli të marrë një sukses në shifrat 11-113 në "Chase Center të San Franciscos, përballë Golden State Warriorsit, që zhytet sërish në krizë. Skuadra e Miamit, e udhëhequr nga Crowder dhe Butler, kishte kontrollin e lojës në tri nga katër fraksionet, ndërsa reagimi i vendësve ishte vetëm në pjesën e tretë, çka nuk mjaftoi për ta shmangur humbjen e tretë radhazi. Në sfidat e tjera Orlando Magicu fitoi me shifrat 135-126 përballë Atlanta Hawksit, Brooklyn Netsi triumfoi me rezultatin e ngushtë 105-106 në transfertën ndaj Indiana Pacersit, ndërsa Denver Nuggetsi mposhti San Antonio Spursin me rezultatin 127-120.

**REZULTATET**

| | |
|---|---|
| Detroit - Charlotte | 76-87 |
| Indiana - Brooklyn | 105-106 |
| Orlando - Atlanta | 135-126 |
| Toronto - Minnesota | 137-126 |
| Milwaukee - Sacramento | 123-111 |
| Dallas - Utah Jazz | 119-123 |
| Denver - San Antonio | 127-120 |
| Golden State - Miami | 101-113 |
| Lakers - Phoenix | 125-100 |

### SHKURT

## Grapci, dikur yll basketbolli, tash punëtor në parking

Valdet Grapci padyshim se do të mbahet mend si një nga basketbollistët më të mirë të Kosovës që nga paslufta. Basketbollisti pejan ishte kampion me Dukagjinin, ndërsa për një edicion kishte luajtur edhe me Prishtinën. Por, Grapci duket se e ka lënë tërësisht profesionin e dikurshëm, pasi po bën një punë të re. Grapci punon në një parking privat në qendër të Pejës, shkruan "Indeksonline". Grapci do të mbahet mend edhe si një nga basketbollistët më të vjetër në vend që ka qenë aktiv. Ai ishte rikthyer në profesion si 44-vjeçar për ta ndihmuar KB Pejën.

## Çmimi i Kumbullës është 30 milionë euro

Marash Kumbulla është një nga zbulimet më të mëdha të kampionatit italian. Talenti i tij është i padiskutueshëm dhe kjo konfirmohet nga interesimi i klubeve më të mëdha të Evropës. "La Gazzetta Dello Sport" raporton se Kumbulla tani kushton 30 milionë euro, ndërsa kjo shifër pritet të rritet akoma më shumë nëse mbrojtësi vazhdon t'i ruajë këto paraqitje deri në fund të sezonit. Interi, Napoli, Liverpooli, Manchester City, Chelsea dhe Borussia Dortmund janë klubet që kanë shfaqur interesim për shqiptarin.

## Juve mendon për Guardiolën

Pas humbjes në fundjavë nga Verona, Maurizio Sarri nuk e ka punën e sigurt në skuadrën e Juventusit. Sipas "Mail Online", drejtuesit e "Zonjës së Vjetër" janë në kërkim të zëvendësuesit të Sarrit dhe emri i parë në listë është ai i Pep Guardiolës. Strategu spanjoll ende nuk e qartësuar të ardhmen e tij e që ende besohet se do të jetë në skuadrën e Manchester Cityt.

## Tensitja Barty ruan pozitën e parë

Tenistja australiane Ashleigh Barty ruan kreun e renditjes botërore për femra edhe pas grand slamit të Australian Open. Ajo ka 8.367 pikë, por tashmë diferenca me ndjekëset është ngushtuar. Në vendin e dytë është ngjitur Simona Halep, me 6.101 pikë, ndërkohë që podiumi kompletohet me Karolina Pliskova. Tenistja amerikane Soa Kenin, fituese e grand slamit të luajtur në Melburn, klasifikohet në vendin e 7-të, duke hyrë për herë të parë në "top-10" tenistet më të mira në botë. Ndërsa Serena Williams klasifikohet në vendin e 9.
Renditja (WTA): Ashleigh Barty (8.367 pikë), Simona Halep (6.101 pikë), Karolina Pliskova (5.290 pikë), Elina Svitolina (4.775 pikë), Belinda Bencic (4.675 pikë).

## Jep dorëheqje Klinsmann

Jurgen Klinsmann ka dhënë dorëheqje nga detyra e trajnerit në skuadrën e Hertha Berlinit. Ish-sulmuesi i njohur gjerman ka njoftuar sot dorëheqjen nga posti i trajnerit të skuadrës, pasi në 10 javë kishte arritur 3 fitore, 3 barazime dhe 4 humbje. "Një periudhë emocionuese për mua, pasi bashkë me stafin tim kishim pranuar sfidën për ta ndihmuar skuadrën dhe në pak kohë kemi bërë gjëra pozitive. Jam i bindur që Hertha e Berlinit do të shpëtojë, por unë kam nevojë për besim dhe pasi reflektova gjatë, vendosa të jap dorëheqje nga posti i trajnerit dhe të rikthehem në rolin e anëtarit të Këshillit të Administrimit", ka thënë Klinsmann.

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU
Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës
04 Nr. 610/01-4186 /2020
Kaçanik,10.02.2020

Në bazë të nenit 5 pika (c) të Ligjit për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës Nr.03/L-068, nenit 35 të Ligjit për Arsim Parauniversitar Nr.04/L-032, nenit 8 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik,Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.10/2018, Për Normativ mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës, shpallë:

## KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës

**1. Shkolla Fillore e Mesme e Ulët „ Qamil Ilazi " në Kaçanik të Vjetër:**
Një mësimdhënës i lëndës, gjuhë shqipe, me kohë të caktuar.

**2. Shkolla e Mesme Profesionale "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" në Kaçanik:**
Një mësimdhënës i lëndës, teknologji informatikë, zëvendësim pushim i lehonisë.

**Detyrat dhe përgjegjësitë për vendet e punës për mësimdhënës:**

- Të realizoj planprogramin mësimor për vendin përkatës të punës, në harmoni me legjislacionin në fuqi, që rregullojnë fushat përkatëse për vendin e tij/saj të punës;
- Të zbatojë detyrat e punës duke siguruar cilësinë dhe kompetencën profesionale në procesin e mësimdhënies;
- Të përgatisë me rregull planin mësimor, në përputhje me Kurrikulën Bërthamë.
- Të zbatojë metodologjitë e reja të mësimdhënies dhe të vlerësimit në përputhje me udhëzimet kurrikulare;
- Të mbajë ditarin personal të vlerësimit të nxënësve;
- Të marrë pjesë aktive në organizimet jashtë mësimore me nxënës dhe të kryejë me përgjegjësi ekskursionet me nxënës brenda dhe jashtë vendit, sipas udhëzimeve të drejtorit të Shkollës;
- Të respektojë autoritetin e drejtpërdrejtë të zyrtarit, të cilit i raporton, dhe t'i kryejë detyrat që mund t'ia caktojë ai/ajo. Detyrat e punës duhet të jenë në harmoni me legjislacionin në fuqi.

**Kushtet e pjesëmarrjes në Konkurs :**
Për vendet e punës për mësimdhënës, kërkohet përgatitja përkatëse profesionale sipas Udhëzimit Administrativ të MASHT-it.Nr.10/2018 Normativi mbi Kuadrin Profesional të Arsimit të Përgjithshëm.
Për aplikim kandidatët duhet të kompletojnë dokumentacionin si në vijim: diploma e fakultetit përkatës, ekstrakti i lindjes, vërtetim për përvojën e punës në arsim ( nëse ka), dëshminë se nuk është nën hetime, CV- në dhe kopjen e letërnjoftimit.

Të gjithë kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit sipas dispozitave ligjore, do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheq 100 pikë apo 50% të vlerësimit përfundimtar.
Vetëm kandidatët që arrijnë së paku 50% te testit me shkrim, ftohen në interviste me gojë.
Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë mblidhen dhe kandidatët me më shumë pikë sistemohen ne vendet e punës.
Njoftimet e kandidatëve për testin dhe orarin e intervistave bëhen në web- faqen e Komunës dhe përmes email-it (sipas të dhënave në aplikacionin e kandidatit).

**Afati dhe mënyra aplikimit.**
Formularët e aplikimit merren dhe dorëzohen në Qendrën për shërbim me qytetar-**Zyra e Pranimit**, kati përdhes.
Të gjitha dokumentet gjatë aplikimit duhet të jenë kopje, ndërsa origjinali duhet të sjellët në ditën e intervistimit.
Dokumentet e pa kompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të shqyrtohen.
Kandidatët për seleksionim dhe intervistim do të njoftohen përmes, postës elektronike (e-mail) ose tabelës së shpalljeve publike.
**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga data e shpalljes në mjetet e informimit publik prej 11.02.2020 deri 25.02.2020.**

Drejtori i drejtorisë
z. Zahir Doda

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

KAÇANIKU
Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Uprava za obrazovanje i kulturu
04 broj . 610/01- 4186 / 2020
Kačanika 10.02.2020.

Prema članku 5 (c) Zakona o obrazovanju u općinama Republike Kosovo br.03 / L-068, članku 35 Zakona o pred univerzitetskom obrazovanju br.04 / L-032, članku 8. Zakona o radu br. 03 / L-212, Administrativno uputstvo (MRSZ) br. 07/2017 o regulaciji postupaka natjecanja u javnom sektoru, Administrativno uputstvo MONT-a br.10 / 2018, o normativu o stručnom okviru općeg obrazovanja, Uprava za obrazovanje i kulturu, objavljuje:

## Oglas

Za popunu slobodnih radnih mesta

1.Niza srednja i osnovna škola" Qamil Ilazi" u Starom Kačaniku:
Predmetni nastavnik, albanski jezik i knjizevnost, za odredjeno vreme

2. Srednja strucna škola " Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" u Kačaniku:
Predmetni učitelj, računalna tehnologija, zamjena porodiljskog dopusta.

Obveze i odgovornosti za posao nastavnika:

- Provesti nastavni plan i program za odgovarajuće radno mjesto, u skladu s važećim zakonodavstvom, kojim se reguliraju relevantna područja za njegovo radno mjesto;
- izvršavati radne zadatke koji osiguravaju profesionalnu kvalitetu i kompetentnost u nastavnom procesu;
- Pripremite nastavni plan i program u skladu s Nuklearnim kurikulumom.
- Primijeniti nove metodologije poučavanja i ocjenjivanja u skladu sa smjernicama kurikuluma;
- Vodite osobni dnevnik procjene učenika;
- aktivno sudjelovati u izvannastavnom učenju s učenicima i odgovorno provoditi izlete sa učenicima u zemlji i inozemstvu, prema uputama ravnatelja škole;
- Poštuje izravne ovlasti službenika kojem podnosi izvještaj i obavlja dužnosti koje su mu povjerene. Radne dužnosti moraju biti u skladu s važećim zakonodavstvom.

Uvjeti sudjelovanja na natječaju:

Za rad nastavnika potrebno je odgovarajuće stručno usavršavanje prema Administrativnom uputstvu MONT-a br. 10/2018 o stručnom okviru općeg obrazovanja.
Da bi se prijavili, kandidati moraju ispuniti sljedeću dokumentaciju: odgovarajuću fakultetsku diplomu, izvod iz matične knjige rođenih, dokaz o radnom iskustvu u obrazovanju (ako postoji), dokaz da nije pod istragom, kopiju životopisa i lične karte.

Svi kandidati koji ispunjavaju uvjete natječaja prema zakonskim odredbama bit će podvrgnuti pismenom testiranju. Pismeni test maksimizira 100 bodova ili 50% završne ocjene. Na usmeni razgovor pozivaju se samo kandidati koji polože najmanje 50% pismenog testa.
Ocjene iz pismenog testa i usmenog razgovora prikupljaju se, a kandidati s najviše bodova postavljaju se na radno mjesto.
Kandidati su obaviješteni o rasporedu ispitivanja i intervjua na web stranici Općine i putem e-pošte (prema podacima u prijavi kandidata).

Rok i način prijave.
Prijavni obrasci se zaprimaju i predaju Centru za usluge građanima - Prijemnoj službi, prizemlje.
Svi dokumenti tijekom prijave trebaju biti kopije, dok bi se original trebao donijeti na dan intervjua.
Nepotpuni i dospjeli dokumenti neće se pregledati.
Kandidati za odabir i intervju bit će obaviješteni putem e-maila ili javnog odbora za objavu.
Oglas ostaje otvoren 15 dana od dana objave u medijima od 11.02.2020 do 25.02.2020.

Direktor
g. Zahir Doda

REPUBLIKA E KOSOVËS KOMUNA E KAÇANIKUT OPŠTINA KAČANIK REPUBLIKA KOSOVA

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**

**C.nr.1363/2019**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**, departamenti i përgjithshëm, gjyqtari Naim Meholli në çështjen juridike të paditësit: Bajram Bajrami nga fshati Pantinë, Komuna e Vushtrrisë me vendbanim ne Mitrovice, rr. "Ahmet Selaci", të cilin sipas autorizimit me shkrim e përfaqëson Av. Elvir Imeri nga Mitrovica kundër të paditurës: Lora Borisova Aleksandrova nga Republika e Bullgarisë tani me adresë të panjohur, gjykata me datën: 17.01.2020 konform nenit 79.3 të LPK-së mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. Caktohet Av. Fuad Haliti** nga Mitrovica si përfaqësues i përkohshëm i të paditurës: Lora Borisova Aleksandrova nga Republika e Bullgarisë tani me adresë të panjohur.

**II.** Përfaqësuesi i përkohshëm në kuptim të nenit 82 të LPK-se, i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjorë, të cilat i ushtron deri sa të paraqiten në gjykatë të paditurit apo përfaqësuesi me prokurë, respektivisht deri sa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

